

ORTHROS I TË PRËMPTIES

Antifona e 15.

Σήμερον ιρεμάται ἐπὶ ξύλου...

Viret sot mbi një dru .

Ài çë ndë ujëra dheun vori (3)

Kurorë glëmbash i vun rrëth kreit
Mbretit t'ëngjëjvet.

Një tsopë t'kukje pér të kjeshur
i vun mbi krahët Atij çë vesh kjielin me mjekulla.

Shplaka duroi të kishë
Ài çë liroi Adhamin në Jordhan.

Me gozhda kle vierrë
Dhëndërri i Klishës.

Me shtizën kle i lavosur
i Biri i Virgjëreshës.

Na i falemi pesimevet t'atë,
o Krisht . (3)

Dëftona të ngjallurit t'atë të
lëvdoshmit.

ORTHROS I TË PRËMPTIES

Mὴ ὁς Ἰουδαῖοι ... *Hys π).P*

Mos kremtojëm si Judhénjtë , pse Pa-
shkët t'ona janë Krishti Perëndi çë
u bë Flijë pér ne;prandai pastronemi
nga çëdò ngjolle e të thieshtë po tho-
mi: ngreuo Zot,ngjallu e shpëtona,o
Mik i njeriut.

‘Ο Σταυρός σου Κύριε... *Hys π).P*

Krikjia jote,o Zot,isht gjella e ngja-
llia e popullit t'ënt e me besim tek
ajò,lëvdojëm Tij Perëndia jinë krikjé-
zuar pér ne . Kijna lipisi.

Dhoksa..kje nin.. ‘Opôsá σε ... *Hys π).P*

Ajo çë të lindi,o Zoti Krisht,si të
vêrrén i vierrë mbi krikjen,po thot:

O Biri jim,çë mister t'huaj,po shoh?

Si Ti,dhënësi i gjellës je vdes me mi-
shët të gozhduar mbi një dru ?

“**Ἐτι καὶ ἔτι....**

Σὺ γὰρ εἰ Βασιλὺς τῆς εἰρήνης
καὶ Σωτὴρ τῶν φυχῶν ἡμῶν, καὶ Σοὶ
τὴν δόξαν ἀναπέμπομεν, τῷ Πατρὶ...

καθ. ‘Εξηγόρασας ...’

Na shpérbleve Ti nga näma e ligjës
me gjakun t'ent të çmuam: Ti, o Zot, me
gozhda i vierrë, me shtizë i shpuar
na prure njerëzëvet pawdekjen: o Sh-
pëtonjësi jinë, paçë lëvdì.

I GJASHTËTI VANGJEJ
(Marku 15,16-32)

Tek ai kjérò ushtarët e kjellën
Iisuin brënda te trëmeja çë isht pre-
torii: e thërritën gjithë shokërin ush-
tare. E veshën Atë me të kukje e i vun
rreth kreit një kurorë e pleksurë me
glëmba. E zun t'i faleshën tue thënë:
T'falemi, rrekjë i Judhénjëvet. Ja .

kërsisiën te kriet me kallëmin e i
pushtijën e vënë më glunjë i bijën
përmist.

E kur pra e kjeshuan, i ndsuartin të
kukjen dhe e veshën me të veshurat e
'tija: e e kjellën sa, t'e vëjën në
krikjë. E shtrëngojën sa t'i kjellëj
krikjen atij një njeri, Simon Kjiri-
neun, t'jatin e Lishëndrit e të Rufit,
se ish'e shkoj çë vij nga përjashta.

E bien Iisuin mbi vendin Golgotha
(çë vien më rar vend krei). E i jipi-
ën të pij verë të përzieme me mirrë:
por Aì ngë mori. E posa çë e vun ngri-
kjë, ndajtën të veshurat e 'tija, tue
shtur shortat mbi ato çëdë kishë nga-
një të mirrëj. Ishë e treta orë e ata
e vun ngrikjë. E ishë e shkruamia
çë dëftoj fajin e 'Tij: RREGJI I JU-
DHENJËVET .

ORTHROS I TË PRËMPTIES

ORTHROS I TË PRËMPTIES

E me Atë bashkë vun ngrikjë di kusarë, një tek e drejta e një tek e shtrëmbëra e' Tij . E u'mbarua e Shkruamia çë thot: "E me të paligjët Ai kle nëmëruar". E ata çë shkojn atëi e nëmiën e tue tundur kriet thoshiën: Eh! Ti çë gorromis Faltoren e te tri ditë e stis, shpëtou e sdripu nga krikjia.

Kështu' kriepriftrat tue kjeshur thoshiën njeri t'jetrit bashkë me shkruesit: Ki t'jerë i shpëtoi, ngë mëndë të shpëtonet Ai vet ? Krishti rregji i Israelit le t'sdripet nani nga krikjia, sa të shohiën e të kemi besë tek Ai.

M a k a r i s m ë

Te rregjëria jote kujtou për ne,
o Zot, kujtou për ne kur vien te
rregjëria jote.

Të lumë të vapkjítë në shpirt, se
e'tiria isht rregjëria e kjiellia-
270.. vet.

Të lumë ata çë klan , se ka
t'jenë ngushëlluarë.

Të lumë të butitë, se ata ka
t' trazhgojën jetën.

Διὰ ξύλου ὁ Ἀδάμ ..

Për një dru Adhami ° nga parraisi kle përzënë,° po për drurin e Krikjes° te parraisi hiri kusari.° Se ai tue ngepsur pemën ° urdhurimin shkeli të Kriuesit;° po ki i vënë bashkë n'krikjë ° njohu Perëndin të fshehur:° kujtou edhé për ne , Shpëtues , te rregjëria jote .

Të lumë ata çë kanë urë e etë li-
gjie, se ka t'jenë tsiturë.

Τὸν τοῦ νόμου Ποιητὴν...

Ligjéruesin e blen ° ata të paligjëshmitë nga dsënësi;° si të paligjët e kjellön pran ° të Pilatit te gjikatorëja;° tue thirrë:"në krikjë vur Atë"° çë në shkretirë ° manën i dha të hajën;° po të gjithë i glasiën

ORTHROS I TË PRËMPTIES

ORTHROS I TË PRËMPTIES

kusarit të fatlumshëm,° tuke thënë
me besë:° kujtou edhé pér ne, Shpétues,
te rregjëria jote.

Të lumë lipisiarët, se ata ka t'
gjejën lipisi.

Tῶν θεοντόνων δὲ συμβοῦσι...

Lusm' e vrasësvet t' Perëndis.
gjindia ë paligjët e Judhenjëvet.
të tèrbuarë lurijën fort ° e Pilatit
thoshiën: "vure ngrikjë" ° ti Krish-
tij të pafajshëm ° e Barabën më mirë.
të lëj i lipiën;° po na Atij thoëji.
me zérin e të lumëshmit e fatbardhë
kusar:° kujtou edhé pér ne, Shpétues,
te rregjëria jote .

Të lumë ata çë kanë zëmërën e
pastrë, se ka t' shohiën Perëndin.

Ἡ ζωηφόρος σου, Πλευρά ...

Brinja jote çë gjellën pru,° si një
burim nga Edhemë i motçëmi ° çë Kli-
shën t'ënde buron,° Krisht,° e e potis
si parrais i mendçëm ° e ndahet katrë
degeshit ° si edhé u nda te moti i
shkuam ° në katrë vangjejet ° tue la-
gur gjithë jetën ° tue gëzuar gjithë
kriesën,° e gjithë gjindet me besë°
tue mësuar° të proskjinisiën ° po rre-
gjérin t'ënde.

Të lumë pakjësorët, se ata ka të
thërriten bij të Perëndis.

Ἐσταυρώθης δὲ ἐμὲ ...

Kleve vierrë pér mua në krikjë° sa të
më buroje ndëjésen,° brinjën t'ënde
pate shpuarë,° sa t'më buroje kro-
nje gjellie ° me gozhdat të mbërthiem
në krikjë ° sa u të besonjë nga të
humbëtitë ° e pesimevet t'atë ° lar-
tësin e pushtetit t'ënt, tue thirrur u
tek Ti: Gjellëdhënës, o Krisht,° Kri-
kjes s'ate lëvdì, o Shelbues, e pesi-
mit t'ënt!

ORTHROS I TË PRËMPTIES

Të lumë ata çë janë përzënë
pär drejtësin, se isht e 'tiria
rregjëria e kjielliavet.

Σταυρουμένου σου Χριστὲ...

Gjithë kriesa , o Zoti Krisht,° zu
të dridhej kur Tij të pa ngrikjë;° e
themelet e dheut ° pér dre të pushte-
tit t'ënt u shkundën gjithë; ° edhé
ijëzet u fshehën,° e villi i faltores°
u shkjuar di tsopash;° e malet zun të
tundeshën,,° e gurët u çajtën ° e ku-
sari besnik ° së bashku me ne thërret:
kujtomë , o Shejbues .

Të lumë jini ju kur ju shajën
e kur ju përzën, e kur ju thonë
çëdò fialë të liga me të rrëme
paj t'meje.

Tò χειρόγραφον ἡμῶν ...

Dorëshkrimin kundra nesh ° Ti e sh-
kJORRE kur të vun ngrikjë, o Zot,° e
ndër të vdekuritë i némëruar,° tue
lidhur tiranin e atiéshëm ° lirove

ORTHROS I TË PRËMPTIES

të gjithë ° nga lidhiet e morties °
me ngjallien t'ënde, o Zot,° pér të ci-
lën klemë ndritur na,° o Krisht, o Pe-
rëndia jinë,° edhé na thërresiëm tek
Ti:° kujtou pér ne, Shpëtues, te rregjë-
ria jote .

Gëzonij e bëni harë , se e madhe
do t'jet rroga juaj te kjiellia.

'O υφωθεὶς ἐν τῷ σταυρῷ ...

O Ti çë i vunë ngrikjë ° e çë fukjin
e vdekjies sglidhe,° e çë shuajte si
Perëndi ° të shkruamen kundra nesh ,
o Zot , ° pendimin e kusarit ° o Ti
çë i vetëm do njerëzit,° jip neve çë
me besë të lusiëm,° o Krisht Perëndia
jinë ° edhé tħerrësiëm tek Ti:° kujtou
edhé pér ne te rregjëria jote .

ORTHROS I TË PRËMPTIES

dhoksa ... Tòv Mætépa ...

Me një mendie të gjithë,° po të lusiëm,° o të besmë,° sa t'lëvdojëm si na nget ° Atin,Birin e Shpirtin Shejt° të cilët në tre Vetë ° janë një i vëtëm Perëndi ° Njëni e papërzieme ° e thiéshtë,e pandarshme,e pakjasurshme ° për të cilën na shpëtonemi ° nga ziari i pisës .

kje nin ... Tòv Mætépa ...

Mëmën t'ënde,o Krisht,° çë prej Shpirtit Shejt të lindi,° e pas lindies vërtetani ° mbeti Virgjérë e dëlirë ° Atë biem përpëra Teje ° për ndërmjetim, ° Rrekjë mëshir-plot ° ndëjésën e mëkatëvet ° të japësh kurdoherë kuj tek Ti thërret:kujtou edhë për ne,Shpëtues, te rregjëria jote .

ORTHROS I TË PRËMPTIES

Proi. Διεμερίσαντο ... 21.

Ndajtën pethkat t'ime ndër'ta e mbi rrobikun shtun shortën.

O Perëndi,Perëndia jim,prirungak U ; përsé më lé ?

I SHTATËTI VANGJEJ
(Mt. 27,33-54)

Tek ai kjérò,të jardhurit ushtarët te vendi çë i thonë Golgothà,çë vién më rar vend krei,i dhanë Iisuit të pij uthullë të përzierë me tamëth:ë Aì si e ngjepsi ngë deshi t'e pij.

Kur pran e vun ngrikjë,ata ndajtën pethkat e 'tij tue shtur shortën,sa të mbaronej e thëna e Profetit:"ndajtën të veshurat t'ime ndër 'ta e mbi rrobikun t'im shtun shortën"

E u ujën ata e atié rrrijën e e ruajën. E i vun sipër mbi kriet e 'Tij

ORTHROS I TË PRËMPTIES

shkruar fajin e 'Tij:

KI ISHT IISUI RREGJI I JUDHENJÈVET.

Ahierna, ata bashkë me Atë vun ngrikjë di kusarë, një tek e dërejta e një tek e shtrëmbëra. E ata çë shkojën e nëmiën, tue tundur krijet e tue thënë: Ti çë gorromis Faltoren e te tri ditë e stis, shpëtou Ti vet. Në je i Biri i Perëndis, sdripu nga krikjia. Ashtu' edhë kriepriftrat tue kjeshuar bashkë me shkruesit e me Plekjët thoshiën: Në isht rrekjë i Israelit, le t'sdripet nanì nga krikjia e e kemi besë.

Ai vu shpresën te Perëndia; le t'e lironjë Ai, në e do : se tha "jam i Biri i Perëndis". Ashtu' edhe kusarët, çë ishën bashkë me Atë ngrikjë, e shkarzejën. Çë tek e gjashta orë njera tek e nëndëta u bë më t'errët mbi gjithë jetën. E mbë të nëndëtën orë Iisui shtu një thirmë të madhe, tue thënë:

278.

Ili, Ili, lamà savahtani, çë vien më rar: Perëndia jim, përsé më lé?

E tsa vetë nga ata çë ishën atié, si e gjegjën, thoshiën: se ki thërret Elim.

E shpejt tue rrriedhur një nga ata, të marrit një shpuzë e njomi te uthulla, e vu mbi një kallëm e ja jipëj t' pij. E të t'jerët thoshiën: le të jesë, shohiën në vien Elia t'e shpëtonjë. E Iisui pameta me zë të math, dha shpirtin. E shi' villi i Faltores u shkjuar ndish, çë lart njera posht; e dheu u tungë e gurët plasën; e varret u sbillën e disa kurme shejtrash çë kishën vdekur u ngjallën e dalë nga varret, posa çë u ngjall Iisui, ata hijtën te hora e shejte e ju dëftuan disëve. E kjindari e ata çë ishën bashkë me atë, çë ruajën Iisuin, kur pan dheun çë tundej e shërbiset çë streksiën, u dreruan shumë, tue thënë: "vërteta Bir Perëndie ishë Ki".

Nanì thuhet Ms.50 v.f. 23

I TETËTI VANGJEJ
(Lk. 22,32-49)

Tek ai kjérò bashkë me Iisuin bijën edhé t'jerë kekjëbërës sa t'i vrisi-ën bashkë me Atë. E kur arrun mbi vendin çë thonë i kreut, atié vun ngrikjë Atë e kekjëbërësit, një tek e drejtat e një tek e shtrëmbëra. E Iisui thëshëj: Tate, ndëjéji ata, se ngë din atë çë bëjën. Pran pethkat e 'Tij i bën piesë piesë e shtun shortën. E populli rrrij e vërrej. Edhé të Parët e përkjeshiën bashkë me ata, tue thënë: të t'jerë i shpëtoi, le t'shpëtonet Aì vet, në isht Krishti, i sgledhuri i Perëndis. E ushtarët e shajën kur i kjaseshën e i jipiën uthullën e i thoshiën: në je rregji i Judhenjëvet, shpëtò vetëhén. Ishë edhé një e shkruam grekjisht e litisht e ebraisht çë thëshëj: KI ISHT RREGJI I JUDHENJËVET.

Një nga ata kekjëbërës çë ishën vierrë te krikjia e némëj Iisuin tue thënë: Në Ti je Krishti, shpëtò Tij edhé

neve. Por ai jatëri mori t'e kjértoj e t'i thoshëj: ngë i trëmbe ti as edhé Perëndis se gjënde ndë një mundim me Atë? E na me të drejt marriëm atë çë na nget nga atë çë kemi bët: por Ki mosgjë të kekjë ka bër. E Iisuit i thëshëj: kujtou ngak u, kur të vish te rregjëria jote. E Iisui i tha atij:

SOT KA T'JESH ME MUA TE PARRAISI.

Ishë si e gjashqë orë e u bë më t'er-rett mbi gjithë jetën njera tek e nëndëta orë. E dielli u err e villi i Faltores u shkjuar në mes. E me zë të mathë Iisui thërriti e tha: Tate, te duart t'áte U lë shpirtin t'im. E të thënët këto duall shpirti. Si pa kjindari atë çë u streks, zu të lëvdoj Perëndin tue thënë: Vörteta ki njeri ishë i dërëjt! E gjithë ato gjinde çë atié bashkë kishën jardhur pér të vërretur këtë punë, të parit këto shërbise çë streksiën, prireshën tue rrahur gjirin e vet. Pér së largu rrrijën e vërrjen këto shërbise gjithë ata çë e njihiën Iisuin e grat çë i kishën vatur prapa bashkë nga Galilea. 281

ORTHROS I TË PRËMPTIES

K a n o n i

O d h a e 5.

Πρὸς Σὲ ὁρθοίζω ...

O Zot, u rri sgjuar përpara Teje çë pér lipisin t'ende pér njeriun çë ra u përuje njerë mosgjë të bëneshe tue vuajtur, pa ndërruar, Pesimet, Ti Fiala e Perëndis çë s'vuan dot. Ëmë pakjien, o Mik i njeriut .

‘Ρυφθέντες πόδας... Αόζα

Me këmbët të larë e ata vetë të pastër tue marrë piesë te Misteri i hynushëm, shërbëtorët t'atë nga Sioni ngjipen te mali i ullinjëvet tue lëvduar Tij, o Mik i njerëzëvet.

‘Ορᾶτε ἔφης... Κήνυν

Ruani, o mikjë, Ti thëshie, mos trazoni se nanë arruri hera çë ka t'jem marrë e vrar nga duar të paligjësh.

Gjithë do t'shprishij tue lënë Mua vetëm. Po do t'ju mbëjéth përsëri sa të ligjëroni dashurin t'ime pér njeri-

un.

ORTHROS I TË PRËMPTIES

Ἐτὶ μαὶ ἔτι...

"Οτι ηύλογηται τὸ πανάγιόν σου ὄνομα, μαὶ δεδοξασταὶ σου ἡ Βασιλεῖα τοῦ Πατρός..."

ι ο ν δ . Τὸν δι ἡμᾶς...

Ejani të këndo jëm Atë çë ë vënë ngrikjë pér ne. Atë vërrén Marieja mbi drurin e i thot:megjithëse je vuani krikjien, Ti je (gjithëmonë) Biri jim, Perëndia jim. O I K O S

Virgjëra Mërie e helmuame se sheh Kjenkjin e 'Saj kjellur të jet theratur, e përsiell bashkë me t'jera gra e thot: Ku je vete, Biri jim? pér kë je bën shtu shpejt këtë dhrom? Ndoshta ë prapë një kurorë në Kanë e je vete atié me kakjë vrapë të bësh verën nga ujët? Vinj me Tij, o Bir, a më mirë rri e të pres? Thuajmë një fialë, o Fialë; mos më shkosh pa

ORTHROS I TË PRËMPTIES

folë, Ti çë më ke mbajtur e dëlirë, pse
Ti je Biri jim, Perëndia jim.

TEK E SHEJTA DHE E MADHE E PRËMPTIE
PËRMENDIËM TË SHEJTËT SHPËTUESË E TË
DRERUASHMË PESIME TË T'IN'ZOTI PERËN-
DI SHPËTUESI JINË IISU KRISHTIT:

pushtimat, shplakat, purtikatat, të sha-
rat, të përkjeshurat, robën e kukje, kal-
lëmin, shpuzën, uthullën, gozhdat, shtizën
e mbi gjithë KRIKJIEN e vdekjen çë
pranoi me-hir pér ne.

Kujtojëm edhë të shpëtuesen skomollë
mbi krikjen të kusarit i mirënlohës
vënë ngrikjë me Atë.

Ti je Perëndia i gjallë edhë
të jesh vdekur mbi drurin.

I vdekur mëlikurë, po gjithë-
monë Fiala e Perëndis gjallë.

Tue vënë pér kliçë atë lutie
"kujtou pér mua, o Zot" kusari
284. sbilli diert e Edhemit.

ORTHROS I TË PRËMPTIES

Për të famasëshmen dhe të pasosme
zëmërë njomë t'ende, o Krisht Perën-
dì, kijna lipisi a m i n .

O d h a e 8.

Στήλην καιϊας

Djemtë të lutshëm përbuziën Statuën
e të kekjies e bërë kundra Perëndis .
Kundra Krishtit Sinedhri i paligjë
i tërbuar mejton kotësira, mendon të
vrasënjë Atë çë te pëllëmba e dorës
mban gjellën t'ënë e të Qilin gjithë
kriesa bekon tue e lëvduar pér mot
e jetë.

'Απὸ βλεφάρων.... *Lëvolutjo, Η.*

Shkundni gjumin nga kjepallat, o dsë-
nësë t'imë, thoshie, o Krisht. Rrini
sgjuarë tue parkalesur mos bini në nga-
rie e më shumë ti , Simon. Më të for-
tit i nget një provë më e madhe. 285.

ORTHROS I TË PRËMPTIES

Njihëmë, Pietrë, se U jam ai çë gjithë kriesa bekon tue E lëvduar pér mot e jetë.

Béþηλov  pioc... *Lëudi Tij*

Një fialë e kekje ngë do t'bienjë nga buzët t'ime. Edhé në të mohofshin gjithë, u dua t'vdes me Tij, mirën johës, thërrisëj Pietri. As mishë as gjak më sbëloj Tij mua, po Ati çë gjithë kriesa bekon tue lëvduar pér mot e jetë.

Báþoç  sof ac... *Lëvoli past*

Ti ngë ke vezhguar gjithë thellësi-rën e Diejës dhe e dituris t'Perëndis.

Abissin e gjikimevet t'imë ti ngë ke ndëlguar, o njeri, thoshëj in'Zot.

Je mishë, mos u mburr, pse do t'më mohosh tri herë, Mua çë gjithë kriesa bekon tue më lëvduar pér mot e jetë.

ORTHROS I TË PRËMPTIES

, Apaçorëvës..., ...

Noui e fajzjt.
Do t'më mohosh si të t'flasiën megji-thëse je i bindur e si gruaja të të kjaset, sa në shpejt do t't' trazonjë.

Do t'klash pran me pikllim, po do të gjesh lipisiar Mua çë gjithë kriesa bekon tue lëvduar pér mot e jetë.

m  para se t  k ndonet Odha e 9.
diak ri thot me z  t  lart:

Tij M ma e t'in'Zoti, M ma e Dri-t s tue dh n  nder me himne Na madh roj m.

T n v t p l w t p v ...

Tij m  t  nderoshme se Hjeruvimt 
e pa t  p rkrahur
m  t  l vdoshme se Serafint 
ç  pa fare u ndotur
t  Lart n Fial  linde
v rteta M ma t  Zotit
po madh roj m na.

'Oléthrioc spesipa...

Një çetë armikjësh të Perëndis
e kekjie shumë
singoga e vrasorëvet
mbi Tij u sul,o Krisht,
e rrëmbeu si kekjëbërës
e gjithësës Krionjësin
çë madhërojëm na.

Nómuov áyvooñvtesç...

Ligjën pa njohur të palutshmit
e Profetavet fialët
tue mejtar më kot
si kjenkjë rrëmbien
sa të thériën pa arsyë
Tij i gjithëve i Zoti
çë madhërojëm na.

Toïç  thvesci  nbotov ...

Kombëvet gjellën e përdhënë
bashkë me shkruesit
të mirriën priftrat
dhanë tue plagosur
me të kekjie smiri
Atë çë isht gjellëdhënësi

e çë madhërojëm na.

'Enýnlawasan nûnës ...

Të rrëthuan si shumë kjenë
Të kërsitën , o Rrekjë
fakjen me shplaka
e u vun të të piejën
ata deshmuantë rreme
e Ti gjithkjish durove
e gjithë neve na shpëtovë

 ti nai  ti

"Otë Së s'ivoñsi pâsai ai Ðuvná-
mësës tñv oýrañvñ, nai Sotë tñg ðo-
zav ánapémpomëv tñv Patarë ...

 zax. Tòv lësëtëv aúthëmërðv...

Kusarin atë ditë të parraisit e bëre
i mirë,o Zot;edhé mua me drurin e
krikjies , jipëmë dritë e shpëtomë.

(tri herë)

ORTHROS I TË PRËMPTIES

I NËNDËTI VANGJEJ
(Ja. 19,25-37)

Tek ai kjérò shtuara afér Krikjies rrijén e Jëma e 'Tij e e motra esë Jëmës s'Tij,Maria e Kleofës e Maria Magdalënë. E Iisui si pa të Jëmën e atié nd'anëzë Asaj dsënësin çë Ai dej mirë,i thot së Jëmës:grua,shi' jit bir.

I thot pra dsënësit: shi' jot' Ëmë. E çë tek ajo herë ki e mori bashkë si e 'Tija. Andai të klënit çë ndëlgói Iisui,se gjithkjish u kishën ssur,sa të sosej e Shkruamia,Aì tha: Kam etë. Ish'atié një poçe e plotë me uthullë: e ata ushtarë muartën e njo-mën një shpuzë plotë me uthullë: e evan mbi një degë isopi e ja kjasën te goja Iisuit .

Kur pra Iisui mori uthullën,aì tha:
s o s i .Etë ujurit kriet,dha shpiqtin.

Judhenjtë pra , se ishë e Prëmpria,sa mos t'kjendrojën mbi krikjien ata kur-me tek e Shtunia-posa ishë ajo ditë e së Shtunies Madhe- i lipën Pilatit sa

ORTHROS I TË PRËMPTIES

t'i çaheshën këmbët e të ndsireshën nga krikjia. Jerdhën andai ushtarët, e të parit i çajtën këmbët,e ashtu të jatrit çë kle krikjësuar bashkë me atë.

Por të jardhurit tek Iisui,si e pan të vdekur,ngë ja çajtën këmbët.

Por një nga ushtarët me shtizën e 'tij i shpoi brinjën e i duall njëiherie gjak e ujë. E kush e pa bë deshmì e deshma e 'tij isht e vërtetë. E aì di se thot të vërtetën:sa ju të kini besë. Por këto shërbise pra klenë sa të mbaronet e Shkruamia:"një asht atij ngë ka t'i çahet".

E pameta jatra e shkruame thot:
"Kanë të vën re mbi Atë çë shpuan .

ORTHROS I TË PRËMPTIES

(për ms. 148, 149, 150 v. f. 31)

E N I

Hxos γ'

Di e të liga bëri biri jim, i parilér Israeli: më la Mua, Kroj i ujit të gjellës e grëmoi pér 'të një putsë gjithë i hapët. Muq më vuri ngrikjë te një Dru e Barabën e lipi dhe e lirroi. U çmend kjielli pér këtë e dielli fshehu rrëmpat e 'tij. Po ti, Israel, ngë u shkjetësove, po më dorëzove morties."Ndëjéjì, o Ati i Shejt:ngë din atë që bun .

Hxos γ'

Çëdò piesë e kurmit t'ënt të shejt duroi pér ne dhunë: glëmbat kriet, fakjia pushtimat, mollat e fakjies shplakat, goja shijën e tamëthit të përzier me uthullë, veshët të poshtrat llastimi,

ORTHROS I TË PRËMPTIES

kurrisi dejet, dora kallëmin, gjithë kurmi t'ishë mbërthier te krikjia, gjymtyrët gozhdat e brinjët shtizën.

O Ti çë vuajte pér ne e na lirove nga epshet; Ti çë u përuje pér dashurinë e na lartësove, o Shelbues ë gjithë-mëndëm, kijna lipisi.

Hxos γ'

Gjithë kriesa dridhet si Të sheh ngrikjë, o Krisht! Pér dren e pushtetit t'ënt themelt e dheut u shkundën. Me të ngjipurit t'at mbi Krikjien fara e Ebrenjëvet u prish. Villi i faltorës u nda ndysh, varret u sbillën e të vdekurit nga varret u ngrëjtën. Kjindari si pa famasmën, u skotis e jot! Emë të rrijti nd'anëzë e me vajtim mëmie zu të thërrisëj: Si nga t'vuhën në lip e ngë ka t'rrah gjirin t'im kur të shoh mëlikurë e vierrë mbi një dru si një vrasës. O i Madh'in'Zot, në krikjë,

ORTHROS I TË PRËMPTIES

në varrë e i ngjallur së vdekurish,
paqe lëvdì !

dhoksa ... *Hxos π>.β'*

Më shkulën të veshurat e në shtun si-
për një mënt i kukjë. Më vun mbi kriet
një kurorë glëmbash e tek e drejta jime
më dhanë një kallëm, sa U t'i drëmoja
si poqe botie .

kje nin ... *Hxos π>.β'*

Dhash kurrisin dejëvet, ngë prora fa-
kjien kur më pushtijën; u parakjita
Gjikatores e Pilatit e durova krikjien
për shëndetën e jetës .

ORTHROS I TË PRËMPTIES

I DHIETËTI VANGJEJ
(Mk.15,43-47)

Tek ai kjérò jerdhi Josefi i Arimathés,
një bujar i ndérshém i çili rrij edhé
ai tue pritur rregjérin e Perëndis,
e kudsoi të hij te Pilati e t'i lipëj
Kurmin e Iisuit. E Pilati u famas si
gjegji se Aì kishë vdekur. E si e dsu
nga kjindari, Josefut i dhuroi Kurmin.

E Josefi mori e bleu një sindhonë ,
e pra sdripi Iisuin nga Krikjia, e pësh-
tollti te pëlhora e e vu te varri çë
ishë ndë një shkëmp. E i rrogolisi
një gur mbi derën e varrit.

E Mëria Magdalënë e Mëria e Josefut
rrijën e vërrejën ku e vëjën .

SI DHOKSA PREPI... v.f.36-39.

Pas "ekfoniosit" Son gar estin
Se jiti ë të pasurit lipisi...
thuhet jetri vangjej e pran këndonen
"aposticha".

I NJËMBËDHETËTI VANGJEJ

(Ja, 19, 38-42)

Tek ai kjérò ju lut Pilatit Josefi i Arimathés, i çili ishë(një)dsënës i Iisuit, po fshehur pér dre të Judhénjet, sa të ndsirëj Kurmin e Iisuit e Pilati la të bëj. Jerdhi pra Nikodhem, ai çë më para kishë jardhur te Iisui natën, tue prur si një kijint litre të pérziemë mirrë me aloe. Muar-në andai Kurmin e Iisuit e e pështoli lën me tsopa pëlhirie bashkë me vajërat éresh, si kanë zakonë Judhenjtë të varrëzojën. Edhé te vendi ku Aì kishë klénë vënë ngrikjë ishë një kopësht, e te kopështi një varrë i ri teku mosnjeri kishë klénë vënë.

Atié pran e vun Iisuin pér të Prëmtien se varri ishë nd'anëzë .

A p o s t i h a

Πᾶσα ἡ ιτισις *Hxos α'*

Gjithë kriesa me dren u ndërrua kur tē pa Tij, o Krisht, i vierrë te Krikjia.

Dielli u err e themelet e dheut u shkundën. Të gjitha vëmajën bashkë me Stisorin e gjithësis. O Ti çë deshetë vuaje pér ne, o i Madh'in'Zot, paçë lëvdì.

Ndajtën pethkat t'ime ndër'ta e mbi rrobikun shtun shortën.

Λαὸς δυσσεβῆς ... *Hxos β'*

Përqë mejton tē kota, o popull i palutëshëm e i paligjë? Përqë Gjellën e gjithësis dënove pë'vdekjie? Oh, çudhi e madhe :Stisori i jetës jipet te duart e tē paligjëvet; e ngrëjtur mbi drurin Dashamirësi i njerëzëvet, sa tē lironjë tē lidhuritë në Adhë e çë Tij ulurijën; o i duruashmi Zot, lëvdì Tij.

E më dhanë për të ngrënë taméth e të pi ja më dhanë uthullë. Ms. 68.

Σήμερον Σὲ θεωροῦσα ... *Hxos β'*
 Sot si të vërren, o Fiala e Perëndis, i vierrë te Krikjia, e pafajshmia Virgjérë me zémérën mëmien e prerë e tue vajtuar me pikllim, me flokët të shpleksurë mbi mollëzat e fakjies s'shejte, tue rrahur gjirin, kështu' po rékoj:

Alia, Biri jim i hjynushëm, alia Dritë e jetës, më dolle nga sit, o Kjenkji i t'in'Zoti. Andai ushtrit e ëngjëjvet, të marrë nga dreja, thonë: I pandëlgua shmi Zot, paçë lëvdì.

Çë moti Perëndia e rregji inë e vepëroi shpëtimin në mes të botës. Ms. 73.

'Επὶ ξύλου βλέπουσα ... *Hxos β'*

Tue të par vierrë mbi Drurin, o Krisht, Tij Kriues i gjithësis e Perëndi, Virgjëresha çë Tij të leu, me pikllim thërrret:

More Biri jim, si perëndoi bukurina nga fitira jote; ngë mëndë të duronjë të të shoh pa të drejt vënë ngrikjë.

Anangasu andai, ngjallu, sa edhë U të shoh pas tri ditë Ngjallien t'ënde së vdekurish.

dhoksa ... Kúpιε ἀναβαίνοντος...

Kur Ti, o i Madh'in'Zot, u ngjipe në krikjë, dre e dridhmë ra mbi kriesën.

Ti mbajte dheun nga të gjëllijturi atë që të vujën ngrikjë, po urdhurove Adhit të shtij jashta të lidhuritë.

O Gjikëtar i të gjallëvet e i të vdekurëvet, Ti jerdhe të dhuroje gjellën, jo mortien! O njeridashës, paçë lëvdì!

kje nin ... "Hōn̄ βάπτεται ιάλαμος *π). 6*

Dha njomet penda e vendimit nga gjikëtarët të paligjë e Iisui gjikonet e dënonet për vdekjie. Vuan kriesa e

-- ORTHROS I TË PRËMPTIES

tërë si t'ë sheh të Zotin mbi krikjian.
O i Mirëth çë për mua vuani te kurmi,
o i Madh'in'Zot, paqe lëvdì !

I DIMBËDHIETËTI VANGJEJ
(Mt 27,62-66)

Mbë ditën e nesërme, çë isht ajo pas
të prëmpties, u mbëjodhën kriepriftrat
dhe Farisenjtë te Pilati e i thonë:
Zot, u kujtuam se ai gënjeshtar tha,
kur ishë gjall: "mbi tri ditë ka të
ngrëhem". Ti urdhurò sa t'jet ruajtur
varri njera tek e treta ditë, mos vijën
dsënësit e 'tij natën e t'e viedhiën
e të thenë popullit: "u ngjall nga të
vdekuritë", e të jet e sprasmia gë-
njeshtrë më e kekjie se e para.
E Pilati i tha atire: ju kini ushtarë
për të ruajtur, etsëni ruanie si dini.
E ata van'e vulosën gurin e i vun
shtrazët te varri sa t'e ruajën.

300.

ORTHROS I TË PRËMPTIES

Agathòn to eksomolojisthe.....
Bukur isht të lëvdojëm

Trisajii
Oti su estin

Apol. Eksigorasas....
Na shpërbleve ... f.268.

Pr. éléison imas
Oti eleimon

Sofia
A p o l i s h i s

Zoti Krisht i çili duroi pushtima,
dejet, shplaka, e Krikjian e vdekjen
për shpëtimin e jetës, i vërteti Pe-
rëndia jinë paj të Rovirgjérës e Shë'
Mëri Mëma e t'in'Zoti e dëlirshme, e
paj të gjithë shejtravet na shpëtoft
e me lipisi na ruashit si i mirë e
njeridashës, a m i n .

301.

ESPERINOI I TË PRËMPTIES S'MADHE

Për msalmin i parë çë sqlidhet
e t'jerët çë këndon v. f. 155-166.

Për parkalesit mistike vërrëj tek
e Shtumia e Madhe.

Fos ilarën f. 167.

~~Akta Lek~~ Stihjirà të parë f. 297 e 298
Pâsia n kritisë Gjithë Kriesa...

Λαδος δυσσεβης Përcë mejton ..
Σήμερον Σε Sot si të vërrén

'Επι ξύλου Tue të par vierrë

Σήμερον δ Δεσπότης... *Hxostja*

Sot i Zoti i kriesës tërë parakjitet
Pilatit e ë dhënë të jet krikjëzuar
Kriuesi i gjithësis, si një kjenkjë
çë vete me-hir të jet thertur. Me
gozhda ë mbërhier e ka shpuar brinjën
e kjas buzët shpuzës Aì çë bë të
derdhej mana . Ë rrahur me shplaka

Liruesi i jetës e na shërbëtorët e
 'Tij isht i përkjeshur Aì çë bëri je-
 tën. Oh, dashuria e t'in' Zoti për nje-
 rezitë ! Aì parkalés Atin e 'Tij për
 ata çë e vun ngrikjë tue thënë: Ndëjéji
 atireve këtë mëkatë: se të paligjët ngë
 din atë çë bëjën pa të drejt.

dhoksa ... Σήμερον δ Δεσπότης... *Hxos II) B'*

Po si Sinagoga e kekjie dënoi për
 vdekjie Rregjin e kriesës ?

E ngë ndiejti ajo turp, kur Aì i kuj-
 toj gjithë të mirat, për t'u mbrojtur,
 tue thënë : O populli jim; çë të bëra
 U ? Mos ngë të mblova Judhén me famas-
 më; mos ngë të ngjalla të vdekuritë me
 një fialë e vétëme? Ngë të shëndosha
 çëdo lëngatë e sëmundë ? Si andai më
 shpaguani ? përcë më harroni ? Në v-
 vend të t'shëndoshurit, ju më mbëloni
 me plagë. Në vend të gjellës çë ju ji-
 pia, ju më vrini, tue vierrë mbi Drurin
 si kekjëbërës Mirëbëresin, si të pali-
 gjë Atë çë ju dha Ligjën, si një i dë-
 nuashëm Rregjin e gjithësis. O Zot, paçë
 304. lëvdì !

kje nin ... *Φορέας* *Hxos II) B'*

Mister i mathë e i tmerrshëm shihet
 sot të mëharonet : ë zënë Aì çë isht
 i pa-parshëm; ë lidhur Aì çë liroi
 Adhamin nga mahkimi; pa të drejt isht
 gjikuar Aì çë gjikòn zëmbra dhe veshi-
 a. Në burg ë mbillur Aì çë mbih abis-
 set. Rri përpara Pilatit Aì kuj për-
 para i rrin të dreruamë fukjët e kjë-
 ellavet. Kriuesi ë rrahur nga dora
 e kreaturës. Ë dënuar te druri Aì çë
 bën ligjë mbi të gjallët e mbi të vde-
 kuritë. Ë mbillur te varri Aì çë pri-
 shi pisën .

O Ti çë gjithëkëjish duron e të gji-
 thë na shpëton nga mahkimi , o Zot i
 pafajshëm , paçë lëvdì .

Fos Ilaròn f.167

Prok. Ms.21,19. Ndajtën pethkat t'ime
 ndër 'ta e mbi rrobikun shtun shortën.

21,1. O Perëndi, Perëndia jim,
 priru ngak u; përsé më lé? 305 .

ESPERINOI I TË PRËMPTIES

Pro f e t s i t

piesë nga libri i TË DALURIT

(33,11-29)

In'Zot flisëj me Moiseun fakje me fakje sikurse flisëj me mikun e 'tij.

Pra Moiseu priej te tendat. Po një dialosh, shërbëtori i 'tij, Isui i biri i Naviut, ngë dilëj nga tenda. E i tha Moiseu t'in'Zoti: shi', Ti mua më thua: "le t'ngjipet ki populli, po me kakjë Ti ngë më ke dëftuar kë do të dërgosh bashkë me mua.

Ti edhé më the: "të njoh më para se gjithë e ke gjeta hir përpara Meje".

Në andai gjeta hir përpara Teje 'ftou fiéllët sa u të Të shoh, sa u të gjenjë hir përpara Teje e ki komb i mathë të njohënjë se ë populli jit.

Ahierna in'Zot i tha: U vet do t't'vijnë përpara e ka të t'jap prëhie.

E Moiseu i tha: në ngë vien Ti vet bashkë me ne, mos na bësh të nisemi këndej. Si ka t'jet njohur me të vërtetë se gjeta hir përpara Meje u e populli jit, në Ti ngë vien bashkë me ne?

306.

ESPEFINOT I TË PRËMPTIES

E do t'jemi lëvduar u e populli jit, përpara gjithë kombëvetesa janë mbi dheun. E i tha in'Zot Moiseut: e atë çë the U do t'e bënji, pse gjete hir përpara Meje e të njoha më parë se gjithë.

E i that Moiseu: bën-më të shoh lëvdin t'ënde. U përgjekjë Perëndia: U do t'vinj përpara teje e në lëvdì e do t'thërrës émbrin t'im ZOT përpara teje e dot'kem lipisi për kë më duket kekjë e mëshirë për atë çë mëshironj.

E shtoi tue thënë: po ngë mëndë të vërrresh fakjien t'ime; mosnjeri nga njërzit mëndë të shohënjë fakjien t'ime e të kjëndronjë gjallë. E tha edhé in'Zot: shi' një vend afër Meje. Ti rrini mbi gurin; ndërsa shkon lëvdia jime, U do të të vë te vëra e gurit e dua të të vë dorën sipër, njera çë shkonj. Pra, so të ndsier dorën, ka t'më shohësh nga aprapa, se fakjia jime ngë ka të dëftonet tij.

307.

ESPERINOI I TË PRËMPTIES

Prok. Ms. 34,1.0 i Madh'in'Zot, mbroj-
më nga ata çë më bëjën të ke-
kjë. 12. Më prieriën të likë
për të mirë.

nga libri i Jobit 42,12-17.

Kështu' in'Zot bekoi të sprasmet
ditë e Jobit më shumë se të parat.

Aì kishë katrëmbëdhiétë mijë dele,
e gjashtë mijë gamilj e një mijë pa-
lë kjesh e një mijë gomare.

I len edhé shtatë bij e tri bija. Të
parën e thërriti Imera, të dijtën Kas-
sia e të tretën Amalhia. E pérposh
kjielliës ngë ndodheshën vashëza më
të bucura se të bijat e Jobit e atire-
ve i dha trazhgim si të völlézërvet.

Rroi Jobi pas sëmundis nj'atrë kjint
e shtatë dhietë vietë. Gjithë vietët
çë rroi klenë dikjint e dizétë. Jobi

ESPERINOI I TË PRËMPTIES

pa të bijët e të bijët e të bijëvet
njer'tek e katräta jini. Jobi vdikjë
plak i nglakuam me ditë. Ë shkruar
se Jobi ka t'ngjallet pameta me ata
çë ka t'ngjallënje in'Zot.

Mbi këtë njeri shkruan një libër si-
riak e thuhet atié se rroi në Ausis
te kufimet e Idhumés e Aravis e émbri
i 'tij ishë më para Jobab.

E posa mori për grua një arabe, pati
një bir me émbër Ennon. Aì vet ishë i
biri i Zarit, një nga të bijët e Esau-
it dhe e jëma ishë Bosorah. Kështu' a
aì ishë i pesti pas Abramit .

piesë nga Profetsia e Isaïs 52,13-
54,I.

Këtë thot in'Zot:shi' se shërbëtori
jim ka të ndëlgonjë e ka t'jet lartë-
suar e lëvduar shumë.

Si ka t'çmenden mbi Tij shumë, vetë:

ESPERINOI I TË PRËMPTIES

kështu' do t'jet pa lëvdì fitira jote ndër njerëzit ,pa hjé ndër të bijët e njerëzëvet.

Kështu shumë kombe do t'çudhiten e rregjëra ka t'milliën gojën e 'tire, pse ata pan atë çë atireve ngë kle lajmëruar mbi Atë e ka t'ndëlgojën atë çë ngë gjegjën. O i Madh'in'Zot , kush do t'ket besë ligjëratën t'enë? e Krahu i t'in'Zoti (fukjia) kuj ka t'jet sbëluar ? Na prun lajmin si njëi fënijë pérpara atij,si njëi rrenjie nga një dhe i that. S'ka hjé tek Aì , s'ka lëvdì. E pam e ngë kishë as hjé as bukuri;të dukurit e 'Tij pa nder; si lënë mbë nj'anë nga të bijët e njerëzëvet. Një njeri helmesh e çë njeh hjidhërimin . Na fshehëm skurse fakjet t'ona nga Aì. Aì kle përbuzur,Na ngë e çmuam. U nglakua me mëkatët t'ona e vuan pér ne . Po na e ndëlgua se Aì ishë me kopos,i munduar nga Perëndia

310.

ESPERINOI I TË PRËMPTIES

e i helmuar. Aì kle plagosur pér mëkatët t'ona;pér paligjësit t'ona kle shtipur. Mundimi i pakjies t'enë mbi Atë;na klemë shëndoshur me purtëkatat çë Aì duroi. Të gjithë na jeni si dele të sbierra,se nga-njeri nesh u sбуar te dhromi i 'tij. Perëndia e nglakoi me mëkatët t'ona e Aì gjith'i munduar ,ngë sbilli gojën e 'tij.

Si një dele kle kjellur pér të theratur e si kjenkjë i pafaj pérpara Atij çë e kjeth, i pa-zë;ashtu' ngë sbill gojën e 'tij. Te të pérunjurit e 'tij gjikimi i 'tij kle ngrëjtur;e jinìn e 'tij kush do t'é rrëfienjë? Pse kle ngrëjtur ngadheu gjella e 'tij.

Kle kjellur të vdisëj nga paligjësit e popullit t'tij. U ka t'jap të likjët pér varrëzimin e 'tij e të kjosmit pér vdekjen e 'tij. Se Aì ngë bëri paligjësi;ngë u gjet gënjin te goja e 'tij; e Perëndia ka t'e pastronjë nga plagët. Në ju falni ndo dhureti pér mëkatët t'uaja,shpirti i jij ka t'shohë-një fakjen e ditëve të glata.

311.

ESPERINOI I TË PRËMPTIES

E ka të det in'Zot të i ndsierënëjë dhëmbien e shpirtit t'tij e t'i dëftojë atij dritë e ka t'i gjeshënëjë me ndëlgim. Ka t'njohënëjë drejtërin e të dërëjtit seshërbeu mirë shumë vëtë e mëkatët e 'tire ka t'i marrënëjë ngrahë Aì. Prandai ka t'ket pör trazhgin shumë vetë; me të fortitë ka të ndanëjë plaçkat, përqë pér ata gjella e 'tij kle dhënë vdekjies.

E u némörua ndër të paligjët e Aì kjelli ngrahë mëkatët e shumë vetëve e kle dhënë pér mëkatët e 'tire.

Gëzou, o shterpë, që ngë lind; këndò e ngre lart zërin t'ënt, ti çë ngë dhëmbe: pse më shumë janë bijët e shterpës se të të martuames.

Më vun te një gropë shum'e humbëtë, te t'më t'errëtitë e te hjeja e morties. Ms. 87,6.

O Zot, Perëndi i shpëtimit t'im, natë e ditë të kam thërritur. Ms. 87,1.

ESPERINOI I TË PRËMPTIES

piesë nga litra e shën Palit Korinthianëvet e para (1,18-2,2)

Vëllézér, fiala e krikjies pér ata çë sbiren ë lentsi, po pér neve çë shpëtonemi ë fukjia e Perëndis.

Ë shkruar: dua t'prish diturin e të dishmövet e mendien e të mendshëmvet të heth posht. Ku isht i dituri? Ku shkruesi? Ku kërkuesi i kësaj jetë? Ngë dëftoi in'Zot sa e lënë ë dituria e kësaj jetë? Posa tedieja e t'in'Zoti ngë dijtijeta të njihëj Perëndin me anën e dituris s'saj, i pëlkujeu t'in'Zoti të shpëtoj të besmitë pr'anë të lëntsisi të ligjërinimit e Vangjejit. Përqë si Judhénjtë kërkuan famasmë e grekrat diejën, na ligjerojën Krishtin vënë ngrikjë që pér Judhénjtë ë skëndall e lëntsi pér grekrat. Pò pér të thërrituritë, a Judhénjë a grekra, Krishti isht fukjia e Perëndis, isht Dieja e Perëndis. Se lëntsia e Perëndis isht më e

ESPERINOI I TË PRËMPTIES

diturë se dituria e njerëzëvet e dobëtia e Perëndis më e fortë se fukjia e njerëzëvet. Vërreni thirrien t'ëj, o vëllezër, përqë ngë janë shumë ndër jush të dijturë pas mishit, jo shumë të fortë, jo shumë bujarë. Po Perëndia sglodhi të lënati e jetës sa të turpëroj të dijturitë; sglodhi të dobëtat sa të turpëroj të fortitë e shërbiset të poshtra e çë shahen të jetës sgłodhi in'Zot, shërbise çë ngë janë gjë, sa t'prishëj ato çë janë. Sa mosnjeri të mburret përpëra Atij. Edhé ju jini nga Aì te Iisu' Krishti, i Çili leu për ne nga Perëndia Dijturi, Dërejtësi, shejtërim, shpërblim sa, si ë shkruar, le të lëvdonet tek in'Zot.

Edhé kur jerdha në mes juve, o vëllëzër, ngë jerdha me lartësi fialie a dije të lajmëroja juve deshmëri e Perëndis. Në mes juve ngë gjikova të dija më shumë se Iisu Krishtin e Këtë vënë ngrikjë.

ESPERINOI I TË PRËMPTIES

prok. Shpëtomë, o i Madh Min'Zot, përgjë ujërat m'arrun njera te shpirti. Ms.68,1.

E më dhanë pör të ngrënë tamëth e të pija më dhanë uthullë. Ms.68,26.

E u errëshin sit e 'tire mos të shohiën Ms.68,28.

V A N G J E J I
(Mt.27,1-38; Lk.23,39-44; Mt.27,39-54;
Ja.19,31-37; Mt.27,55-62)

Tek ai kjérò mbajtën këshill kriepiftrat edhë Plekjët e popullit kundra Iisuit sa t'e vrisiën.

E lidhur e kjellën e e lan te duart e Pontsië Pilatit, kjivertarit.

Kur pa Judha, çë e kishë përdhënë, se Iisui kle gjikuar për vdekjie, u pendua

ESPERINOI I TË PRËMPTIES

e mori tridhietë dënarët të 'rrgjëndë e ja prori kriepriftravet edhé Plekjëvet tue thënë: u mëkatrova se dhash gjak të pafajshëm. Por ata i thanë:çë duam na? Ti ka t'e vërrresh. E ai shturi atié te faltoria të 'rrgjëndit e jiku e vate u vuár.

Kriepriftrat pran muartin ata dënarët të 'rrgjëndë e thanë:ngë isht drekjë se köta t'i vën te tesori i Faltores, se janë çnim gjaku. E ata mbajtën kë-shill e blen me ata dënarë dheun e sh-tëmbarit pér të varrëzuar të huajit.

Andai kle thërritur ai dhe "dhe gjaku" njera m'nani. Ahierna u mbarua e thëna e Profetit Jeremi çë thot! e mu-artin tridhietë dënarët të 'rrgjëndë, çmimin e të çmuamit, të atij çë kle çmuar nga të bijët e Israelit, e ja dhanë të blijën dheun e shëmbarit ashtu si më kishë urdhuruar in'Zot".

ESPERINOI I TË PRËMPTIES

E Iisui u ndoth përpëra Kreut e Kreu i piejti tue thënë. Ti je rregji i Judhe-njëvet. E Iisui i tha atij: Ti e thua.

E kur e ngalesiën të parët e priftravet edhé Plekjët, Ai ngë i përgjegjej gjë fare. Ahierna i thot Atij Pilati: ngë gjegje sa deshmojën kundra Tij?

E atij ngë ju përgjekjë te mosnjera fialë akjë se i Pari famasej fort.

Për ditën e kremties kishë zakonë Kreu i vendit t'i lëshoj gjindes një të lidhur çë dejën ata. E ahierna kishën një të lidhur të njojur, çë i thoshiën Bara-ba. E kur ishën atié bashkë mbëjedhurë, Pilati i tha atireve. Kë doni ju t'ju lëshonjë : Barabën a Iisuin çë thonë Krisht? Se e dij se ja kishën dhënë atij te duart pér smir. E si rrij ujur mbi thronin e Ligjës, i dërgoi të thënë gru-aja e 'tij:mos të kesh gjë ti me atë të dëréjt, se sot pér atë u reva shumë te ëndërra.

E të Parët e priftravet e Plekjët sh-tijtë gjinden të lipiën Barabën e Iisuin t'ë vrisiën. U përgjekjë pra Pilati e i tha atire:çilin doni të ju lë nga të di ? E ata i thanë:Barabën. I thot atire Pilati: e çë ka t'ë bënj Iisuin çë thoni Krisht ? I thonë atij të gjithë: le t've ngrikjë. I thot atire:kjivertari:se çë të kekjë ka bër Aì ? E ata po.. lurijën më shumë tue thënë:le t've ngrikjë. E të parit Pilati se ngë e ndihëj e se po bënej tra-zin,mori tsa ujë e lajti duart përpara gjindes tue thënë: u ngë i ftës te gjaku i këtij të Déréjti: ka t'ë vërreni ju.. E gjithë populli u përgjekjë e i tha:Gjaku i 'Tij mbi ne e mbi bijët t'anë. Ahierna i lëshoi atire Barabën e Iisuin, posa është e bëri t'ë dërsëllojnë, ja dha te duart sa t'ishë vënë ngrikjë. Ahierna ushtarët e kjivertarit, si

e muartin Iisuin e e prun te Pretori, u mbëjodhën gjithë shokëria ushtare nd"anëzë atij. E posa çë e dëgeshën,i vun ngrahë një mëndil të kukjë,e pleksurë një kurorë glëmbash ja vun mbi kriet e një kallë te dora e dërejtë e 'tija. E tue u përglunjur përpara Atij e shajën tue thnë:T'falemi,o rregji i Judhénjëvet. E tue pushtijtur mbi Atë, i mirriën kallëmin e ja kërsisiën te kriet. E posa çë e patën kjeshuar,i ndsuartin atë mëndil,e veshën me të veshurat e 'tija e e kjellën t'ë vëjën ngrikjë. E si ish'e diliën,gjetën një njeri Kjiriné,me embër Simon; këtë e shtrënguan të oglakoj krikjien e Atij.

E të jardhurit te vendi çë i thonë Golgotha-çë vien më rar vend krei-i dhanë të pij uthullë të përzier me tamëth: e Aì si e ngjepsi ngë deshi t'ë pij . Posa pra e vun ngrikjë,ata ndajtën pethkat e 'Tij tue shtur shortën,sa të mbaronej e thëna e Profetit: "Ndajtën të veshurat t'ime ndër 'ta e mbi rrobikun t'im shtun shortën".

ESPERINOI I TË PRËMPTIES

E ata u ujën e rrrijën atié e E ruanjën. E i vun sipër mbi kriet e 'Tij shkruar fajin e 'Tij :

KI ISHT IISUI RREGJI I JUDHENJËVET .

Ahierna ata bashkë me Atë vun ngrikjë di kusarë,një tek e dërejta e një tek e shtrëmbëra. Një nga ata kekjëbërësë çë ishën vierrë te krikjia e némëj Iisuin tue thënë:Në Ti je Krishti,shpëtò Tij vet edhé neve. Por ai jatéri mori t'e kjértoje t'i thoshëj:ngë i trëmbe tias edhë Perëndis se gjënde te mundimi një me Atë? E na marriën me të dërejt atë çë na nget nga atë çë kemi bër:por Ki ngë ka bër gjë të kekjë. E Iisuit i thëshëj:Zot,kujtou ngak u , kur të vish te rregjëria jote. E Iisui i tha atij: vërteta U të thom,sot ka t'jesh me mua te Parraisi.

E ata çë shkojën E nëmiën tue tundur kriet e tue thëhë: Ti çë gorromis Faltron e te tri ditë e stis,shpëtò vetëhën t'ënde. Në je i Biri i Perëndis , sdripu nga krikjia. Ashtu' edhë krieprift

ESPERINOI I TË PRËMPTIES

trat tue kjeshur bashkë ne shkruesit e me plekjët thoshiën: T'jerë ai shpëtoi, vetëhën ngë mëndë t'e shpëtonjë; në isht rrekjë i Israelit,le të sdripet nani nga krikjia e kemi besë. Ai vu shpresën te Perëndia,le t'e lironjë, në e do: se tha:"se jam Bir Perëndie.

Ashtu' edhë kusarët çë ishën bashkë me Atë ngrikjë,e shkërzejën.

Çë tek e gjashtëta orë njera tek e nëndëta,u bë më t'errët mbi gjithë jetën. E mbë të nëndëtën orë Iisui shtu një thirnë të madhe tue thënë: Ili,Ili, lamà savah tanë , çë vien më rar : Perëndia jim,Perëndia jim, pse më le ?

E tsa vetë nga ata çë ishën atié,si e gjegjën,thëshiën: se ki thërrret Elin.

E shpejt tue rrriedhur një nga ata,të marrit një shpuzë,e njomi te uthulla, e vu mbi kallëmin e ja jipëj të pij.

E t'jerët thoshiën: le t'jesë,shohiën në vien Elia t'e shpëtonjë.

E Iisui pameta me zë të mathë, tue thirrë,dha shpirtin .

ESPERINOI I TË PRËMPTIES

E shi' villi i Faltores u shkjuar ndishë, çë lart njera posht; e dheu u tund e gurët plasën . varre u sbil-lén e disa kurme shejtrash çë kishën vdekur, u ngjallën. E të dalë nga varret, posa çë u ngjall Iisui, ata hij-të te kjiteti shejt e u dëftuan disave. E kjindari e ata çë ishën bashkë me atë, çë ruajën Iisuin, kur pan dheun çë tundej e shërbiset çë streksiën, u dreruan shumë, tue thënë: "Vërteta Bir Perëndia ishë Ki.

Judhenjtë pra, se ishë e Prëmptia, sa mos t'kjendrojën mbi krikjien ata kurme tek e Shtunia-posa ishë ajo dita e së shtunies madhe-i lipën Pilatit sa t'i çaheshën këmbët, e të ~~ndësinëghën~~ nga krikjia. Jerdhën andai ushtarët, e të parit i çajtin këmbët, e ashtu! t'jatrit çë kle krikjëuar bashkë me Atë. Por , të jardhurit tek Iisui, si e pan të vdekur, ngë ja çajtin këmbët: po një nga ushtarët me shtizën e 'tij i shpoi brinjën e i duall njëi herie

ESPERINOI I TË PRËMPTIES

gjak e ujë. E kush e pa bë deshmi e deshmia e 'tij isht e vërtetë. E aì di se thot të vërtetëtë, sa ju të kini besë. Por këto shërbise pra klenë, sa t'mbaronet e shkruamëja: "Një asht Atij ngë ka t'i çahet". E pameta jatëra e shkruame thot: "Kanë të vën 'ré mbi Atë çë shpuan."

E ishën disa gra atié çë vërrejën për se largu, ato çë Iisuit i kishën vatur prapa çë nga Galilea tue shërbier të.

Tek ato ishë Mëria Magdalënë e Mëria e Jakobit e e Josefit edhë e jëma e të bijëvet e Zebedheut.

E kur u ngris jerdhi një njeri i kjosëm nga Arimathéa, me émbër Josef, çë edhë aì u kishë mësuar nga Iisui.

Ki u kjas te Pilati e i lipi kurmin e Iisuit. Ahierna Pilati urdhëroi t'i jipej kurmi. E Josefi , të marrit kurmin , e pështolli me pëlhirë të pastrë e e vu te varri i 'tij i ri ,

ESPERINOI I TË PRËMPTIES

çë kishë prer te guri:e posa çë i rro-
golisi një gur të mathë te dera e va-
rrit,mori e vate .

Po ishën atié Mëria Magdalënë e ja-
tëra Mëri ,ujurë pérpara varrit.

Ipomen pandes

Oti eleìmon kje filànthropos....

K a t a k s i o s o n

Bën-na të mirë , o Zot , te këjò
mbrëma të ruhemë na të pa-mëkatë.

I bekuar je , o Zot , Perëndia i Atë-
ravet t'anë edhé émbri i jit isht i
kënduar e i lëvduar në jetë të jetë-
vet,ashtu'kloft.

Kloft , o Zot , lipisia jote mbi ne,
ashtu' si kemi shpresuar tek Ti.

I bekuar je , o Zot , mësomë Ti të
déréjtat t'ote.

I bekuar je , o i Zot , le t'njoh u
të dërejtat t'ote.

ESPERINOI I TË PRËMPTIES

¶ bekuar je , o i Shejt,ndritëmë Ti
me të dërejtat t'ote.

O i Madh'in'Zot,lipisia jote isht pér
gjithëmonë:veprat e duarëvet t'ote Ti
mos përbuz.

Tij të nget çëdo nderim,himn e lëv-
dì Atit,Birit dhe Shpirtit Shejt,nanì
e pér gjithë monë mbë ëjetë të jetëvet,
amin.

Plirosomen

I to kratos tis vasiliás....

a p o s t i h a

(tue kënduar këta këndime prifrat
kjelliën "Kurmin"-epitaliin- e t'inë
Zoti te Varri, 'tafos'.)

"Ote èn toù çúlou...

Kur nga Druri Tij vdekur i Arimathës
sdripi i gjithësis gjellën,me vaj é-
résh e pëlhirë Tij ,Krisht,pështroi

ESPERINOI I TË PRËMPTIES

e nga malli ishë shtijturi me zëmërë e
me buzë të dëlirin Kurmin t'ënt të pu-
thëj. Po mbajtur nga dreja i gjëzuam
po thërrisëj Tij:lëvdì,Dashamirës,të
përunjurit t'at.

Perëndia rregjeron:u pështrua me ma-
dhëشتì,u ngjesh u rrëthua me fukjì.

Kur te varri i ri për të gjithë kle-
ve vënë,o Lirues i gjithëve, pisa e
kjeshuarë , si të pa , u zalis. Themel-
let u dreruan,dierit u çajtën,varret u
hapën,të vdekuritë u ngallën.

Atë herë Adhami me-hir i gjëzuam thë-
rrret Tij: lëvdì , Njeridashës,të pér-
unjurit t'at.

E kështu' jetës i dha kjëndresë e
s'do tundet.

Kur te varri me kurm deshe t'ishe
mbillur,o Ti çë mbete si Perëndì i
papërshkruashëm,i pakufizuashëm e të
326.

ESPERINOI I TË PRËMPTIES

morties mbille dhomët, e Adhit gjithë
mbrazë,o Krisht,rregjérin.

Atë herë këtë e Shtunie të hjynushmes
lëvdì të bekimit e të të shkëlkjierit
t'ënt e bëre e mirë.

Shpis s'ate i përkét shejtëria,o Pe-
rëndì për ditë të glata.

Kur Fukjìt Tij,o Krisht,të pan nga-
lesur nga të kekjitë si gënjeshtar ,
lipisia jote e pathënëshme i skotisi
e si pan gurin e varrit t'vulosur me
duart me të cilat të dëlirën Brinjë
shpuan.

Po për shëndetën t'ënë,gëzonen tue
thritur:lëvdì , Njeridashës , të pér-
unjurit t'at.

Dhoksa ... kje nin ...

Σὲ τὸν ἀναβαλλόμενον τὸ φῶς ὥσ-
περ ιμάτιον ...

ESPERINOI I TË PRËMPTIES

Tij që vishe me dritë si me një mënt,
si të-sdripi Josifi me Nikodhimin nga
Druri e të pa vdekur, mëlikuë, pa varrë,
të dhëmbëshmin vajtim zuri e tue u hji-
dhëruar po thoshëj: Oh, i ëmbëli Isuth!

Dielli pak më para, si të pa wiérrë mbi
krikjien, u pështrua e u err. Dheu në dre
u shkun e villi i Faltores u shkjuarr.

E nani u vet jam e shoh që mortie de-
she Ti të duroje përmua! Si ka të t'var-
rëzonj, o Perëndia jim? Si ka të t'pësh-
tronj me pëlhurë? Me çilat duar ka të
ngas të pangarin Kurmin t'ënt? Me që
köndime ka të lëvdonj të vaturit t'at,
o Lipisiar? U lartësonj pesimet t'atë,
u lëvdonj varrin t'ënt e të Ngjallurit
t'at. O i Madh'in'Zot, paçë lëvdì!

ESPERINOI I TË PRËMPTIES

Nin apolis.....

Le nani, o i Madh'in'Zot, shërbëto-
rin t'ëntsa të ve në pakjie mbi fia-
lën t'ënde, pse e pan sit t'imë Shën-
detien t'ënde, që bëre gati përpara
fakjies së gjithë popujvet: dritë pér
të ndriturit e gjindëvet, e lëvdì të
Israelit, popullit t'it.

Trisaji

Oti su estin

I ndershmi Josif e ndsori nga ai Dru
Kurmin t'ënt të dëlir ndë pëlhurë e
pështolli me aromë të çmuamë tek ai
varr i ri i ri dhe e vu me kujdes të
mathë.

Gravet Miroforënje Ëngjëll që rrrij
përpara varrit i tha: aromët janë të
mirë pér të vdekuritë: Krishti u dëf-
tua i pangarshëm nga prishëria.

A p o l i s i s

Zoti Krisht , i vërteti Perëndia
jinë,çë deshi pér shëndetën t'ënë
të duroj të dreruashmitë pesime,
Krikjien çë na jep gjellën e Varrin
në kurm, paçit lipisi pér ne,si i
MIRË e i DASHAMIRË , a m i n.

+

O R T H R O S

i

TË SHTUNIES S'MADHE

ndëra sgjidhen "6 msalmet" (v.f.5)
Prifti thot mistikjish lutjet (f.61)
në vend të "alilujariit" këndonet
Theòs Kjirios

Perëndì isht in'Zot e na u dëftua
neve:i bekuar Aì çë vién në émbër të
t'in'Zoti.

Lëvdoni t'ën'Zonë e thërrin émbrin
e 'tij të shejt.

Gjithë popujitë më kanë rrrethuar,e
në émbër të t'in'Zoti u kam ruajtur
nga ata.

Këjo punë u bë pr'anë të t'in'Zoti
e isht e famasëshme pörpara sivet
t'anë.

331.

pas litanis çë sos me "Oti prépi"

këndonen këta tparie :

I ndershmi Josif... (f.329)

Kur u sdripe nga vdekjia,o Gjellë e pavdekshme,atëherë Pisës vdekjian i dhe me të shkëlqjerit e Hjynis;atëherë nga nënshtresat e dheut të vdekuritë ngjalle. Gjithë fukjìt të larëtë mbikjellore po thërresiën: o Gjel-lëdhënës Krisht,Perëndia jinë,lëvdi Tij.

Gravet miroforë ... (f.329)

eti kje eti...

Oti son to kratos...

k a t h i s m a t a

Σινδόνι μαθαρῷ ...

Josefi i lipi Pilatit të shejtin Kurm,e liejti me vaj érësh të çmuam

dhe e vuri te një varrë i ri e pësh-tiéllë te një pëlhirë e pastrë. Këtu' mirëprurëset menatnet njize po thér-risiën : dëftona si kishe thënë,o Zoti Krisht,Ngjallien .

dhoksa... kje nin ... Eçéorësav ...

U çmendën koret e Ëngjëjvet kur të pan Tij çë rri në gji të Atit,të rri-je nanë te varri, i Pavdekshmi si i vdekur. Tij ushtrit e Ëngjëjvet rre-thojën e lëvdojën ,bashkë me të vdeku-ritë e Adhit,si Krionjës e Zot.

më para se të zënjet këndimi i Kàno-nit thuhet Ms. 50 (v.f. 23)

ORTHROS I TË SHTUNIES

K à n o n i

O d h a e p a r ë

Kúmati θαλάσσης ...

Të bijët e atireve çë klenë shpëtuar varrëzojën te dheu Atë çë tiranin përndjekës varrëzoi te valat e dejtit.

Po na si vashazit këndojëm t'in'Zoti; pse me të madhe lëvdì u lëvdërua Aì.

Kúriε Θεέ μου ...

O Zot Perëndia jim, një himn të faluri, një kënkë varri Të këndonj Tij çë paj, të varrëzuarit t'ënt më sbill diert e gjellës e me vdekjen t'ënde mortien e Adhin i vret.

"Avw σε ἐν Θρόνῳ ...

Lart mbi një thron, posht te një varrë, Ti, o Perëndi Shpëtues, me vdekjen t'ënde shkunt fukjít e kjiellit e t'pisës.

334.

ORTHROS I TË SHTUNIES

S'mënd't'ndëlgonet: Ti Krionjësi i gjellës, na dëftone vdekur !

"Iva σου τῆς δόξης ...

Sa t'mbushie me lëvdin t'ënde të gjitha, u sdripe te të kthellat e dheut e atié ngë mënd't'fshihia naturën t'ime e rarë në Adham; po të varrëzuarit t'atë më përtërijti, o Njeridashës!

O d h a e t r e t ë

Σὲ τὸν ἐπὶ ὑδάτων ...

Gjithë kriesa tue par të vierrë mbi Golgotën Tij çë vore dheun mbi ujërat pa klënë mbajtur gjékund qmendet fort shumë e thërret: S'ka njeri i shejt veç Teje, o i Madh'in'Zot!

Σύμβολα τῆς ταφῆς σου...

T'jerë herë tue shumësuar famasmët na parakjite simbollët e varrëzimit; nani i sbëlon misteret e Njeriut Perëndiedhé atireve çë janë në Adhë.

E ata thërresiën: s'ka njeri i shejt, veç Teje, o i Madh'in'Zot.

335.

"Ηπλωσας τὰς παλάμας...

Tue ndejtur krahët mbi krikjien Ti mbëjéth bijtë t'atë të shprishurë.

Nanì i pështieillé në pëlhirë te varri liron ata çë janë robë e të ulurijën: s'ka njeri i shejt veç Teje, o i Madh'in'Zot.

Μνήματι οὐαὶ σφραγίσι...

Ti i pambajtëshëm lëhe me-hir t'jesh mbajtur nga varri e vulet e 'tij.

Vërteta me veprime të hjynushmë sbëlove pushtetin t'ënt atireve çë të këndojën: s'ka njeri i shejt, veç Teje, o i Madh'in'Zot.

eti kje eti

Oti si i o Theòs imòn

kathisma: Τὸν τάφον σου Σωτῆρο

Ushtarët çë ruajën varrin t'ënt, o Shpëtues, me të shkëlkjiemit e Ëngjëllit çë ju duk gravet t'i thëshëj se u ngjalle, vdkjën. Na lëvdojëm Tij çë na liron e i përmisemi Tij çë u ngreve

nга varri , i Vetëmi Perëndia jinë .

ODHA E 4.

Τὴν ἐν σταυρῷ...

Tue par çë më para të hjynushmin vetmohim t'ënt Abakumi, i famasur po thërret: Ti e hputë pushtetin Sundonjësvet tue folë atireve në Adhë si i gjithëmëndëm.

Ἐβδόμην σήμερον ...

Shejtërove të shtatëtën ditë çë më para kishe bekuar tue u prëjturit nga të punuarit. Gjithkjish Ti përtërin e prapë krion tue ruajtur të Shtunien, o Shpëtues e Krionjës!

Πωμαλαιότητι...

Tue mundur me fukjin e më të fortit shpirti u nda nga mishët tue hputur të di lidhiet të morties e të Adhit, Fialë , me pushtetin t'ënt!

'O "Aðηç Aðyε ...

Adhi, si të përpokji, o Fialë, u hel-mua , se të pa njeri i perëndishëm, një njeri i plot me varre e mundësor i gjithëmëndëm: me këtë pamie i mori dreja.

ODHA E 5.

Θεοφανίας...

Tue veguar dritën pa perëndim çë Ti te mirësia jote na dëftove me të jar-dhurit t'atë, si Isaia natën rrrij sgjuar pérpara Teje thërrisëj: Do tëngrëhen të vdekuritë nga varret e 'tire e do t'ngjallen e gjithë në dhe do t'gëzonen .

Νεοποιεῖς ...

Ti Krionjësi, sdripur mbë dhe, tue u veshur me botë, përtérin të bijët e Bottës. Varri e pëlhura sbëlojën misterin çë tek Ti mbaronet. Në vërtetë Këshill-tari bujar shfakjë mendimin e Atit t'ënt çë tek Ti mua më përtérin bukurë.

Διὰ θανάτου...

Me vdekjen t'ënde Ti shndërron atë çë isht të vdekshëm; me varrin atë çë prishet tue bër të paprishëshme e të pavdekshme naturën njerëzore, o i Madh'in'Zot. Përgë mishët t'atë ngë pa prishëri e shpirti i jit ngë kle lënë në Adhë si i ngisëj të huajvet.

'Eξ ἀλοχεύτου . . .

I ler nga Virgjëra e i lavosur me shtizën, o Krionjësi jim, te brinja nga e çila gjeshe Evën e re, Ti Adham i ri, u kjëllove njëi gjumi i mbinaturshëm e gjellëdhënës e nga gjumi e nga prishëria sgjove Gjellën, se je i gjithë-mëndëm .

ODHA E 6.

Συνεσχέθη ...

I gjëllitur nga pishku ngë kle mbajt tur Jona. Si nga një shtrat u ngre jashta shtazës se aì përfakjësoj Tij çë vuan, Tij vënë te varri. E uluriti ruanjësëvet :çë ruani të kota e të rrëme, ju sbuartit rastin e lipisës.

'Avypéthης ...

Kleve vrar, o Fialë, po jo ndajtur nga mishët. Mbigjithëse Faltoria jote kle prishur te hera e Pesimevet, edhë ashtu! një Vet ishë te Hjynia e te Kurmi. Te të di me të vërtetë je një Bir, Fiala e Perëndis, Perëndi e njeri.

Βροτοκτόνον ...

Njerëzis e jo Perëndis ftesa e Adhamit bëri dëm. Edhé të ket vuajtur natura botie e mishit t'atë, p Zot, Hjynia

mbeti e ndërrrove të prishurit në paprishi, e të gjellës e paprishi, e 'ftove kroin e Ngjallies.

Βασιλεύει ...

Adhi zotëròn jinìn e njerëzëvet, po jo për gjithëmonë: Vënë Ti te varri, o i gjithëmëndëm, me dorën t'ënde gjallsore çajte kliçet e morties e kuj çë moti ati flëjën ligjërove shpërbimin i vërtet, o Shpëtues, çë u bëre i Paralinduri së vdekurish.

etì kje eti ...

Si gar i Vasilévs...

k o n d . Tù ḅvnsorov ð nλε̄sac...
Aì çë mbilli abisset duket i vdekur! I liejtur me aromë e i pështiéllë me një pëlhirë të një varrë ë sdripur si i vdekur i Pavdekshmi!

Grat vijën sa t'E liejën tue klar me

idhnim e thonë: Këjo isht e Shtunia e bekuame tek e çila Krishti ka të sgjonet pas tri ditë e ka t'ngrëhet.

Ai çë mban gjithkjish ëngréjtur mbi Krikjien e gjithë kriesa e kla viérrë mëlikurë mbi Drurin. Dielli fsheh rrëmpat e 'tij e dritën e 'tire sbieriën ijëzit. Dheu me shumë dre shkundet, dejti jik, gurët çahen, shumë varre sillon e kurmet e disa shejtrave ngrëhen. Rëkon te të humbëtitë Adhi e Ju-dhénjtë përgatiten të shpifiën Ngjalles e Krishtit. Po grat ulurijën: Këjo isht e Shtunia e bekuame tek e çila Krishti flë sa t'ngrëhet tek e treta ditë.

342.

TEK E SHEJTA DHE E MADHE E SHTUNIE NA NDERIËM TË HJYNUSHMIT TË VARRËZUAR E TË SDRIPURIT NË ADHË TË ZOTIT T'ENË PERËNDI E SHPËTUES JINË IISU'KRISHTI;

Paj t'tire fara jonë kle thërritur nga prishëria e kjellurë te gjella e pasosme.

Më kot e ruani varrin ju ushtarë:

pse një varrë ngë mënd' t'mba-një gjellën .

Paj të pathënëshmit të sdripur t'atë , o Krisht Perëndì, kijnna lipisi.
a m i n .

ODHA E. 7.

"Αφραστον θαῦμα.. Oh,çudhi e path...
Ai çë te furri liroi të shejtrat Djemë nga flakat, nani ë vënë te varri vdekur pa frimë pér shëndetën e neve çë i këndo jëm: o Perëndì Shelbuesi jinë, Ti je bekuar!

343.

ORTHROS I TË SHTUNIES

Tëtrotat "Aðης..."

Adhi u shpua te zëmbra si priti Atë
 çë me shtizën kle shpuar te brinja e
 ankonet se isht prishur nga ziarri i
 hjynushëm për shëndetën t'ënë, të ne-
 ve çë këndojojmë:p Perëndì Shelbuesi
 jinë,Ti je bekuar.

"Oλβιος τάφος ...

Varrë i lum,tue pritur mirë Krionjë-
 sin si i kjëlluam çë flë,ti u bëre
 një vistar i hjynushëm gjellie për
 shëndetën t'ënë, të neve çë këndojojmë:
 o Perëndì Shelbuesi jinë,Ti je bekuar!

Νόμῳ θανόντων ...

Pas ligjës e të vdekurëvet Gjella e
 gjithësis pranòn të jet vënë te varri
 e këtë e bën krua e ngjallies për shën-
 detën t'ënë,e neve çë këndojojmë:o Perën-
 di Shelbuesi jinë,Ti je bekuar !

Μία ύπηρχεν ...

E në Adhë e në varrë e në Edhem një
 e Hjynia e pandarshme e Krishtit ne
 t'Jatin e me Shpirtin Shejt për shën-
 detën t'ënë,e neve çë të këndojojmë:
 o Perëndì Shelbuesi jinë,Ti je bekuar!

ODHA e 8.

"Εστηθι φρίττων...

Famasu, o kjiell, e dridhu; u shkun-
 dshin themelet e dheut.Shi' Aì çë jet
 te më i larti kjiell ë nëmëruar ndër
 të vdekuritë,isht pritur te një varrë
 i vogël. Atë , o djemë bekoni,prif-
 tra këndoni, o popull lartësoni për
 mot e jetë.

Λέλυται ῥχραντος ...

Faltoria e papërlieme isht prishurë!
 Po ngrën me 'të tendën të rarë. E i
 dijti Adham sdripet njer në të thellat
 dhomë të Adhit për të parin. Atë,o
 djemë bekoni,priftra këndoni,o popull
 lartësoni për mot e jetë.

ORTHROS I TË SHTUNIES

Нéпauтai τóλμa...

Sosi gudsimi i dsënësëvet, po më i
mirë ë Josefi i Arimathës:si sheh
vdekur,mëlikurë Perëndin i gjithësës
e lip dhe e verrëzon tue uluritur:
Atë , o Djemë bekoni,priftra këndoni,
o popull,lartësoni për mot e jetë.

*Ω τῶν θαυμάτων ...

Oh,famasmë të reja,o mirësì,oh,i
pathënëshmi durim ! Me-hir lëhet të
jet vulosur përposh dheut Ai çë jet
te më i larti kjiell e Perëndi ë nga-
lesur si një kekjëbërës. Atë,o Djemë
bekoni,priftra këndoni,o popull,lar-
tësoni për mot e jetë.

ODHA E 9.

Mή ἐποδύρου ...

Mos të klash përmua,o Mëme,se më
sheh te varri,Mua është Ti Virgjérë më
linde. Do t'ngrëhem e do t'kjell me
mua në lëvdì t'pa pushim,si Perëndi,
ata çë me besë e dashuri Të lartëso-
346.

jën Tij.

ORTHROS I TË SHTUNIES

'Επὶ τῷ ξένῳ σου τόνῳ...

Të të jashtëzakonshmit të ler t'atë
kleva e lume se ngë njoha,si pas na-
turës, dhëmbie. Po nani çë të shoh
vdekur,pa frimë,një shtizë lipi më
shpon me mizori. Atëherë ngreu nani
sa t'më madhërojën .

Γῇ με καλύπτει ἔιδυτα...

Dheu më fshehu përcë desha U,po dri-
dhen dieruesit e Adhit tue më par të
kjeh një e veshurë e plotë me gjakun
e ndëshkimit,o Mëme. Pse U Perëndi
mund armikjët mbi Krikjien e do t'n-
gjallem përsëri e të t'jap lëvdì.

'Αγαλλιάσθω ἡ πτίσις...

Le t'gëzonet kriesa,gjithë njerëzit
të bëjën haré se Adhi armiku kle dçe-
shur.le t'kjasen grat me vajërat.Do
t'lironj Adhamin me Evën e gjithnjeri
e të tretën ditë do t'ngjallem.

247.

ORTHROS I TË SHTUNIES

T A EΓ K Ω M I A

S T A S I S e 1.

Zoti Krisht, o Gjellë, edhé Ti në varr?
 E gjithë ëngjëjvet ushtrit po famase-
 shën sa u përuje, i Larti Zot !

2. Po si vdes Ti gjella? Si ndë varrë
 Ti po rri? Ngë je Ti që përfaron vde-
 kjen, që të vdekurëvet gjellë i jep?

3. Madhërojëm Tij, Iisu' Rrekjë e
 nderojëm varrin e Pesimet t'atë;
 me ata prej prishëris na lirove!

4. Ti që kufi vure dheut, te një varr
 i vogël! Ti rri o Rregji i gjithëve
 sot, të vdekuritë tue ngjallur nga va-
 rret.

5. Iisu' Krishti jim, o Rregji i gji-
 thësis, në Adhë që kërkon ç'u sdripe;
 ndoshta t'lirosh jinìn e njerëzëvet?

6. T'Zotin i gjithëve e shohiën vde-
 kur e në varrë i ri po vuhet Kush m-
 brazi varret nga të vdekuritë.

348.

ORTHROS I TË SHTUNIES

7. Zoti Krisht, o Gjellë, edhe Ti në
 varr? e vdekjen me vdekjen t'ënde
 prishe e gjellënjetës i dhe.

8. Me kekjëbëresit si kekjëbërés,
 o Krisht, u nömërovë e gjithë neve drej-
 tërove nga e kekja e t'motçmit trathö-
 tar.

9. Nga gjithë njerëzit më i hjashtë
 në bukurì, duke si i vdekur pa hir, Ti
 ç'naturën sbukurove të kujdò.

10. Si ka t'duronjë Adhipranin t'ënde,
 o Zot, e sa më njizë ngë ka t'bienjë i
 errur nga të shkëlkjiemit e dritës
 t'ënde?

11. O Isuthi jim i ëmbël, o shpëtuese
 dritë, te një varr i erröt si fshihe?
 I parrëfieshmi, i pathënëshmi durim!

12. Edhé natura shpirtullore, e ëngjëj-
 vet ushtrit sborën gojën përpara mi-
 sterit t'varrimit t'ënt i pathënëshëm.

ORTHROS I TË SHTUNIES

Te të jashtzakonshmit të ler t'at kleva e lume se ngë njoha si pas naturës, dhëmbie. Po nani çë të shoh i vdekur, pa frimë, një shtizë lipi më shpon me mizori. Atëherë ngreu nani, sa t'më madhërojën). v.f. 347.

13. O çudhì e madhe, o ngjarie pashokë! pa frimë isht kjellur i frimës dhënësi e nga duart e Josefit isht varrzuar!

14. Ti në varrë perëndon, o Zoti Krisht, nga gjithi i t'it' Eti pa u larguar. Oh, mister i mathë e bashkë çudhì !

15. Të kjielliës e dheutsi rrekj' i vërtet, edhé në varr'të vogël i mbillur, të njeh gjithë jetë e Të proskjannis.

350

ORTHROS I TË SHTUNIES

16. Kur të vun në varrë, o Krionjës Krisht, themëlet e Adhit u shkundën e të vdekurëvet u sbillën varret.

17. Ai çë mban dheun në dorë e në kurn vdikjë, nani përposh dheut ë mbajtur e nga mbajta e Adhit liron të vdekuritë.

18. Nga prishia u ngjipe, Gjella jine Shpëtues, kur ndër të vdekuritë u sdripe i vdekur e hputë e Adhit vargjet.

19. Nani si një llëmpë dritie i Perëndis Kurminën dheut si nën modhiit fshihet e të errëtit'e Adhit përzë.

20. Ushtrit e ëngjëjvet me Nikodhimin e me Josifin rrëdhiën sa t'vënë të pambajturshim te varri i vogël.

21. I vdekur se deshe e vënë nën dheut o Gjellëdhënës Iisu', Ti ngjalle mua vdekur se ngë mora 'veshë'.

22. Gjithë kriesa ndorreron për pesimet t'atë, pse sëbashku me Tij vuajën t'gjitha, se t'njohиën si përbajtës i gjithësis.

351.

23. I urmi Adhë si Tij gjëlliti, o Iisu', shkëmbin e gjellës si i vdekshëm, që moti vdekurë ndsori jashtë.

24. Ti, o Krisht, u vure, posht në varr i ri, e përtërije naturën e njerëzëvet si së vdekurish u ngröjte, Perëndi.

25. Në dhe Ti jerdhe sa t'shpëtoje Adhamin e në dhe si ng'e gjete, o i Zot, njer'né Adhë u sdripe t'e kërkoje.

26. Gjith'jeta, o Fialë, shkundet me dren, e illi i menatës rrëmpat e 'tij fsheh, si Ti drith' e madhe nën dhe sdripe.

27. Si njeri se, Ti vdes o Shpëtues, po të vdekuritë Ti ngjall si Perëndi, nga varret e nga honi i mëkatëvet.

28. Vaje e lotë mbi Tij derth e Dëlira e si Mëmë Tij të thërrisëj, o Isuth: si Tij, Biri jim, mënd't! varrzonjë?

29. Si një kokje drithi vënë në gjë të dheut, Ti bëre një kallì t'plot me pemë tue ngjallur bijët e Adhamit.

30. Përposh dheut fshihe, si dielli nani e me natën u pështrove e morties, po ngreu mi shkëlkjieshëm, Shpëtues.

31. Sikur Hënza fsheh diskun e diellit, 'shtu varri Tij të fsheh, Shpëtues, nani si njeri nga vdekja i prishur.

32. Gjella Krishti tue ngjepsur mortien, nga mortia gjithë njerëzit liroi e gjithëve gjellën dhuroi.

33. Tue u par në mishë si Adham i ri, të vietrin Adham nga smiri i vrar në gjellë prure tue vdekur Ti.

34. Ushtritët engjëllore të shtruar vdekur si të pan pér ne, o Shpëtues, u qudhiten e me krahët fakjen pështrojën.

35. Kur, o Fialë, të sdripsi nga druri i vdekur, te varri Josifi të vuri, po Ti ngreua si Perëndi e shpëtona.

36. Shpëtues, gëzimi i Ëngjëjvet, nani Ti shkakton po lipë, në kurm i vdekur e pa frimë.

37. I ngrëjtur mbi drurin Ti lartëson të gjallit e nën dhe, si kleve vënë, të vdekuritë me Tij ngjalle, o i Madhi in'Zot!

38. Shkunde gjumin e kurmit si luân, Shpëtintar, e po ngjallet si kelyshë i vdekuri, tuke hedhur t'kurmit plekjérin.

ORTHROS I TË SHTUNIES

39. Pate shpuar brinjën Ti çë brinjën e Adhamit more sa t'gjishie Evën e pastrimi lume burove.
40. Çë moti kjenkji therej fshehtas, po Ti flijone haptas,i Pafajshëm, e kriesën gjithë Ti pastron.
41. Kush mënd't'flasënje mbi këtë gjë e tmerrshme ? Zoti i gjithë kriesës vuan sot,se të vdisëj ka dashur për ne.
42. Arkëtarin e gjellës si e shohiën vdekur? Të famasurë jan'Ëngjëjtë. Si nö varrë sdripet in'Zot ?
43. Nga brinja e shpuarë derdhet gjella mbi atë çë gjellën më hëkji e me atë mua gjellën më jep.
44. I shtruar mbi Drurin Ti mbëjeth njerëzit e shpuar te brinja gjellëdhënëse buron ndëjesë gjithëve,o Iisu'.
45. Bujari,o Shpëtues isht marrë nga dreja e si i vdekur me kujdes nö varrë të vë,i qëmendur nga e tmerrshmia fitirë.
46. Si i vdekur tue dashur të sdripëshe nën dhe,te kjielli Ti rrnarte nga dheu ata ç'i kishën rar,o Iisu'.

ORTHROS I TË SHTUNIES

47. Edhé të dukesh vdekur,i gjall si Perëndì,Ti po rrnar te kjielli nga dheu ata çë i kishën rar, o Iisu'.
48. Edhé të dukesh vdekur,i gjall si Perëndì,të vdekurëvet gjellën Ti po jep; atë ç'më vreau Ti po vret.
49. Oh,me çë haré,oh,me çë lumëri! Ti mbushe ata çë n'Adhë ndodheshën si drita jote atié shkëlkjéu!
50. Proskjinis pesimet,lëvdonj varrin, madhëronj pushtetin,o njeridashës;paj t'tire nga epshet(prishës) u lirova.
51. Kundra Teje,o Krisht,shpata e të fortit ngë pret më e shpata e Edhemit isht prerë.
52. Si kjenkjin e 'saj Delia thertur e pa,fort e munduarë bënte vaj,tue mal-lëngjier grigjen t'ulurij.
53. Ndonsë varrzone,ndonsë vete në Adhë,Ti,Shpëtues,varret i mbraze,e A-dhin , o Krisht , dçeshe .

ORTHROS I TË SHTUNIES

54. Si deshe,o Shpëtues,Ti vajte nën
dhe e gjellë prapë të vdekurëvet i
dhe e të Atit në lëvdì i prure.
55. Njéri i Trinis në kurm pér ne vuani
mortie e turpshme;dridhet dielli,sh-
kundet dheu .
56. I Judhës pasardhësit si nga burim
i idhët,te një gropë vun Iisuin Perën-
dì,Atë çë manën dhënë i kishë.
57. Gjiknjësi si i gjikuar para Pi-
latit gjikëtar parakjitet e dënonet
pér vdekjie te druri i Krikjies pa të
drejt.
58. Popull vrashor krielart Israel,si
të vien çë Barabën liron e Lironjësin
në krie vë ?
- 59 Ti çë gjeshe Adhamin me dorën t'ën-
de nga bota,e njeriut,pér atë,naturën
more, e , se deshe , ngrikjë kleve vë-
në.

356.

ORTHROS I TË SHTUNIES

60. Atin t'ënt,o Fialë,tue marrë 've-
shë,njer te Adhi i tmerrshëm u sdripe,
e ngjalle e njerëzëvet jinin.
61. Oh,drita e jetës! oh,drita jime!
o Isuth fort i dashuri,vajtonte Vir-
gjëresha me pikllim.
62. O popull vrashor smirkekjë,gjak-
marrës,si sheh pëlhirën e sudharin
të Krishtit ngjallur,t'ardhëshit turp.
63. I ndyem me gjak , o dsënës vrashor,
eja 'ftomë shkakun e të kekjies q't'bë-
ri trathëtar të Krishtit.
- 64.O i lënë e i verbër e krejt i shkret,
më para bëre njeridashësin e pran shi-
te Mirin me çmim.
65. Të Mirit kjëllor çmim ti more.Çë
pate pér t't'çmuarit shkëmbim?tërbim
gjete, o i mahkuami satàn.
66. Në je mik i të vapkjëvet e t'vien
kekjë pér Mirin çë derdhet si flijë
pér shpirtin,si Dritëdhënësin shet me
ar?

357.

ORTHROS I TË SHTUNIES

67. O Perëndi, o Fialë, o haré jime, si ka t'duronj' varrin t'ënt tri ditë? si mëmë zëmbra më shkijret.
68. Kush ka t'më japënëjë ujë e lotësh burime, theonimfia Virgjérë thriste sa të kla të ëmblin Isuthin t'im?
69. O ju male, o ju vaña dhe shumiza e njerëzvet, klani e vajtoni ju të gjithë me Mua Mëma e t'ënët Perëndi.
70. Kur ka t't'shoh pameta, o Shpëtues Dritë e pa-mot, gëzimi e hareja e zëmërës t'ime, te helmi thriste Virgjëresha.
71. Ndonse si shkëmb i pa-tsopëtar, o Shpëtues, pranove t'ishe çar e derdhe si krua gjellie ujë gjallsor.
72. Si nga një krua i difishmi lum neve na potis nga brinja jote e gjellën të pavdekshme po trazhgojëm.

358.

ORTHROS I TË SHTUNIES

73. Deshe, Fialë, të ftoneshe vdekur te Varri, po Ti rron e njerëzit do të ngjallësh me të ngjallurit t'at si po the. dhoksa,.. Himnojëm, o Fialë, Tij të gjithëve Perëndi me Atin e me Shpirtin Shejt e të hjynushmin varrë lëvdojëm. kje nin ... T'lumërojëm, o Mëm'e t'inë Zoti e dëlirë e t'Birit t'ënt Perëndia jinë varrin tri ditësh me besënderojëm.

S T A S I S e 2.

1. Të ka hjé të madhërojëm Tij Gjellëdhënësin çë ndejte duart mbi Krikjen e pushtetin e armikut drëmove.
2. Të ka hjé të madhërojëm e gjithësës Stisorin pse na kemi me pesimet t'atënga ato lirin e nga prishëria.
3. U shkund dheu e dielli, Shpëtues, u fsheh, se Ti dritë pa perëndim perëndove me kurmin në varrë.

359.

ORTHROS I TË SHTUNIES

4. Flëjte , Ti , o Krisht , gjellë - dhënësin gjum në varrë e nga gjumi i rëndë i mëkatës,ngreve Ti e njerëzëvet jinìn .

5. E vëtmia ndër grat pa dhëmbie U leve Tij,o Bir,dhëmbie nanì kam me të pesuarit t'at të paduruashëm,thriste e Hjynushmia.

6.Lart , o Shpëtimtar ,ku je bashkë me Atij i pa-ndar ,posht i vdekur i shtruar nën dhe,dridhen kur të shohiën Serafimtë.

7.Skjirret villi i faltores me të krikjëzuarit t'ënt,fshehiën dritën e 'tire ijëzit , si Ti fshihe,o Diell nën dhe.

8.Ti çë në fillim me një shenk e dheut sodite rrethim,si njeri pa fri-më hire nën dhe;dridhu o kjiell,si e sheh .

9. Perëndon nën dhe Ti çë me dorën t'ënde gjeshe njeriun sa me pushtetin t'ënt të math të ngrësh nga vdekja e njerëzëvet shumizën.

ORTHROS I TË SHTUNIES

10. Vajtim të shejt ejani t'i këndoni Krishtit çë vdikjë ;si miroforët ahier-na të gjegjemi t'falurit e Krishtit: GËZOU.

11. "MIRI" me të vërtetë çë ngë sos kurr je Ti,o Fialë;andai edhé Tij "mirë" të faliën të gjallit si i vdekur miro-forët.

12. E Adhit rregjérin drëmon kur je Ti, o Krisht,te varri;me vdekjen Ti vret mortien e njerëzin liron nga prishëria.

13. Lume gjellie tue derdhur e Perëndis dituria,sdripet te varri tue dhënë gje-lle atireve në honet të pahijturë të Adhit.

14. Sa të njerëzëvet naturën të drëmu-ame të përtërija,vdekjie desha plagë te kurmi jim; me vajtime mos u rräh, o Mëme.

15. Nën dhe perëndove,o dritëprures i drejtëris e të vdekuritë skur nga gjumi Ti ngreve e t'Adhit përzure gjithë errësirën .

16. Fara dyfishe gjellëdhënëse në gji
të dheut mbillet me lotë sot, po tue
bir pameta jetën ka t'gëzonjë.

17. Adhami u trëmp kur jitsëj Perëndia
në parrais; gëzonet nani se e sheh në
Adhë, se atë herë kishë rar e nani ngrë-
het.

18. Lume lotësh Mëma jote derdhi mbi
Tij çë te varri me kurmin je vënë.

Ngreu, o Bir, të thot, si m'kishe
thënë.

19. Kur me lutësi te varri i ri, të
fshehu Josifi, vaje lipi me himne mun-
die, si t'kish hjé, Shpëtues, Të këndojoj.

20. Tij të gjithësisë ëmbëlsira kur Më-
ma të pa të pije të pir të idhët, me
lotë lakëj fakjet me pikllim.

21. Ngrikjë, si Të pa mëma jote, me go-
zhda i mbërthier, nga gozhdat e një e
idhët dhëmbie e pati zëmbrën e shpuarë
e nga shigjeta.

22. Plagosurë jam U kekjë e më shkji-
rret zëmbra, o Fialë, tue par therien
t'ende e patëdrejtë, thoshëj gjithë e
pastra tue klar.

362.

— ORTHROS I TË SHTUNIES —

23. Si ka të t'mbih, o Fialë, sizit të
ëmbël e buzët, si ka të t'varzonj'si
një i vdekur? ulurinte tue dredhur
Josifi.

24. Himne Josifi e vajtime varri Ni-
kodhimi Krishtit këndojojn nani të
vdekur e me ata përzihen Serafimtë.

25. Perëndon nën dhe, dielli i drej-
tësis Shpëtues e në lip sduket hënza
çë të leu, se drita jote vien e i lip-
set.

26. U droth si të pa Tij gjellëdhënë-
sin, Shpëtues, Adhi; Tij ç'e gjesh nga
pasuria e 'tij e çë ngjalle të vdeku-
rit çë moti.

27. Dielli shkëlkjén i ndritshëm pas
natës, o Fialë, e Ti sikur nga shtra-
ti tue u ngrëjtur, do t'lambarisësh
tue shkëlkjier.

ORTHROS I TË SHTUNIES

28. Dheu shkundetme dre si të ka në gji e tue u shkundur, o Kriues , sgjon gjithë të vdekurit,o Shpëtues.
29. Me Mirin Tij,o Krisht,Nikodhemi dhe bujari nani me viersh'i ri të pësh-tielliën;dridhu,thresiën,jetë e tërë.
30. Ti perëndon, Ti Kriuesi i dritës e me Tij perëndon drita e diellit e kriesa me dre t'ligjëron si Bëresi.
31. Shkëmbi i skalisur krien angonie fsheh gurin,Perëndin s'i vdekur i vdekti fsheh nani te varri. Dridhu o Dhe !
32. Shihe dsënësin çë deshë mirë e t'ët ëmë,o Bir i ëmbël,jip zë,thriste tue klar e Dëlira.
33. Ti çë jep gjellë,o Fialë,ngë i dhe vdekjie Judhenjëvet çë të vun në krikjë,po i ngjalle të vdekurit.

364.

ORTHROS I TË SHTUNIES

34.Bukuri,o Fialë,as hjé kur pesoje pate,po shkëlkjeve kur u ngjalle,tue sbukuruar njerëzit nejrrëmpa të hjynu-shme .

35. Ill pa perëndim,perëndon me kurm nën dhet;s'duronte të të vërrej dielli e te filli i mjesditës u érr.

36. U errën,dielli e Hënza , , o Shpëtues, si shërbëtorë tö urtë çë me të zeza vishen.

37. Mbigjithse vdekur si Perëndi të njohu kjindati. Si,o Perëndi,ka të t'ngasme këto duar;dridhem gjith'i të-rë , thret Josifi.

38. Adhami u kjëllua e nga brinja leu vdekja;po kur Ti u kjëlllove,Fiala Pe-rëndi,nnga brinja jote jetës gjellën buròn .

-- ORTHROS I TË SHTUNIES

39. Flëjte pér pakë e i dhe gjellën të vdekurëvet e Ti tue u ngjallur ngjalle të kjëlluamitë çë moti, o i Mirë!
40. Si u ngrëjte nga dheu, burove verën e shpëtimit, Ti o dhri çë jep gjellë. Lëvdì pesimevet e Krikjies!
41. Si udhëhékjstë e ushtrivet shpir-tullore të pan mëlikurë, i përgjakët, o Shpëtues, si duruan gudsimin e krikjë-zonjësvet ?
42. Me një mënt të kjeshuri kleve veshur Ti çë vëre sipër jetën e çë stise kjiellin me ijze e dheun sbukurove me gudhi.
43. Si Laradash i shpuar te brinja, o Fialë, dhe gjellë bijëvet t'atë të vdekurë tue i buruar me ujë gjallsore.
44. I pari Iisu' kjëndroi diellin sa t'mundëj armikjët, po Ti u pështrove vet, o Iisu' tue prishur krietarin e të errëtit.

366.

45. Tue kjëndruar i pa-ndar në gji të Atit, njeri deshe të bëneshe, Lipisiar e në Adhë u sdripe, o Krisht .
46. Viret sot mbi një dru, Aì çë ndë ujëra dheun vori e uji kriet pa frimë nga dheu e ki s'duron e shkundet me dre.
47. Mjera U, o Biri jim, vajtpn Virgjëra e thot: Tij çë shpresoja t'shihia rrekjë nani të shoh t'dënuar ngrikjë.
48. Kështu më tha Gavrili, kur u sdrip tek U: se rregjëria e Isuthit Birit t'im ki't'kjëndroj pér mot monë.
49. Mjera U: e Simonit u mbarua profitia: se shpata jote, Emanuìl, më shpoi zëm-brën më nj'anë e nj'etrë.
50. Dielli u droth e fshehu dritën e 'tij kur të pa Tij, o Krisht dritë e paparshme, të fshiheshe pa frimë te varri.
51. Klaj me pikllim e dëlira Mëma jote kur te varri të pa Tij Perëndì i pathë-nëshëm, i pasosëm.

367.

ORTHROS I TË SHTUNIES

52. Mortien t'ënde e dëlira Mëma jote tue shikuar, o Krisht, me idhnim, mos mënò ndër të vdekuritë, të thoshëj.

53. Adhi i frikëshëm, kur të pa u drerua, o diell i pavdektë të lëvdës e robët e 'tij njize dha.

54. E madhe, e dreruashme shihet pamia nani, o Shpëtues: Gjellëdhënësi i kriesës po vdes sa gjellë gjithëve të japënjë.

55. Brinjë shpuarë ke e gozhda te duart, o Zot, sa t'bësh mirë me plagën t'ënde, plagën e duarvet, t'gjishravet.

56. Nga njeri në shpi klajti ahierna t'birin e Rahjiliës; nani t'Birin e Virgjérës kla i Apostojvet kori me Mëmën.

57. Shplaka në fakjie i dhanë Krishtit me duar Atij çë me dorën e 'Tij Adhamin gjeshi e drëmoi e kafshës dhëmbët.

58. Me himne Tij, o Krisht, Krikjen edhé varrin, na të gjithë të besmë po lëvdojëm, të liruamë nga mortia paj t'varrit t'ënt.

ORTHROS I TË SHTUNIES

dhiksa... Perëndì i pa-zënëfill, o Fialë bashk'e pasosme, mfortsò fukjít e të besmëvet kundra çëdë armiku, o i Mirë.

kje nin ... Ti çë linde gjellën, o Virgjér'e dëlirë, pushò skëndajitë e Klishës e mbretëroft pakjia, o e Mirë.

S T A S I S e 3.

Jini të gjitha varrin t'ënt me kënka po nderiën, o Zoti jim.

2. Me kujdës nga Druri Josefi të sdripi edhë të vuri në varrë.

3. Grat e mira jerdhën tue prur Tij vaj éresh me hir, o Krisht, te zëmbra.

4. Ejani t'i thomi kënka vaji t'Zotit na gjithë bij të Krietary.

5. Si i vdekur të gjallin bashkë me Miroforët me urtësi po liejëm.

6. O i lumi Josif, varréz Kurmin e Krishtit gjellëdhënës.

7. Ata çë ushkjeu me manën ngrëjtën thëmbrën e 'tire kundra Mirëbëresit.

ORTHROS I TË SHTUNIES

8. Ata çë ushkjeu me manën bien Shpëtimtarit tamëth e uthuh.
9. Oh,lëntsi e madhe!oh,çë vrasie e Krishtit nga ata çë vran profetrat .
- 10.Si shërbëtor i lënëtrathëtoi dsënësi e Diejës Abissin.
11. Shpëtuesin tue shitur robë kjëndroi Judha trathëtari.
12. Si thot Salomoni gropë e humbët ë goja e Judhenjëvet të paligjë.
13. Judhenjëvet të paligjë ndër rruaga të shtrëmbëra,glëmba e lekje.
14. Kriussin si i vdekur vu në varrë J'sifi bashkë me Nikodhimin .
15. Gjellëdhënës Shpëtues , lëvdì pushtetit t'ënt çë Adhin gorromisi.
- 16.Si të shihëj praptë gjithë e dëli-ra si Mëmë të vajtoj .
- 17.O Paraverë e ëmbël,o i Biri jim, ku t'veate bukuria ?
18. Kur Ti vdikje , o Fialë,gjith'e shejta Mëma jote të t'vajtoj zu me lotë.

370.

ORTHROS I TË SHTUNIES

19. Me pushtetin t'ënt të hjynushëm tue vdekur mortien vrave,o Perëndia jim.
20. Kle gënjier gënjeshtari e shpëtonet i gënjiemi me diejën t'ënde,Perëndi.
21. Në një fund pisie trathëtari kle gorromisët,te putsi i prishëris.
22. Glëmba edhë lekje udhët e të shkretit e të t'shmëndurit Judhë.
23. Bashkë do t'vdesiën, o Fialë,gjithë ata çë t'krikjëzuan,o Rregji i gjithësis.
24. Gjithë ata çë derdhën gjak te putsi i prishëris do t'vdesiën bashkë.
25. O i Birii Perëndis , Rregj'i gjithësis,si deshe të vuaje ?
26. Mëma si sheh t'Birin viérrë në Krikjë lurin e vajton.
- 27.Kurmin gjellëdhënës Josifi vu në varrë bashkë me Nikodhimin .

371.

ORTHROS I TË SHTUNIES

28. Ulurin Mëma me lotë të ndsehta e me të shkjérrë zëmbrie.
29. O drita e sivet t'imë, o i Bir, o zëmbra jime edhé Ti këtu në varr!
30. Mos vajtò , o Mëme , t'jenë li-ruar u vuanj Adhami dhe Eva.
31. Do t'lëvdonj , o i Bir , të lar-tën lipisi, se gjithë këto durove.
32. Uthuhë e tamëth , o Lipisiar pi-ve sa t'prishie shijën e vietrë.
33. Mbërthier je te një dru, Ti çë popullin t'ënt pështrove me një re..
34. Miroforët , Shpëtues , si jerdhën te varri,vaj éresh të falën.
35. Ngjallu , o Lipisiar , e neve nga honet na ngrë të ~~Adhit~~.
36. Ngreu, o Gjellëdhënës, Mëma çë Të leu, tue derdhur lotë të thot.
37. Po ngreu shpejt, pa ngjallu, o i Bir , më ndsir helmin Mua Mëmës çë Të leve.

ORTHROS I TË SHTUNIES

38. E kjiellit fukjít me dren u vrë-rën si vdekur të pan .
39. Dhurò neve ndëjésën e çë me të dashur të nderiën pesimet t'atë me dhimë.
40. I pari Josif të shpëtoi si jiku tue mbajtur Tij e nj'etrë nanë të varrzon.
41. O pamie e dreruashme, o Fiala e Perëndis , si mënd'dheu të t'pështro-një.
- 42.Kla e vajton e dëlira Mëma jote, Tij vdekur , o Shpëtues .
43. Gjith'zëmbrat t'ona shkunden,për-para Varrit t'ënt, o Krionjës i gji-thësis.
44. Miroforët jerdhën njize te varri jit i shejt e i shprishën vaj éresh.
45. Pakjien Klishës t'ënde, shpëtim popullit t'ënt me ngjallien fal , o zot.

ORTHROS I TË SHTUNIES

dhoksa ... O Trini Perëndì At , Bir , e Shpirti i Shejt , kij lipisi pér jetën.

kje nin ... Të shohiën t'Birit t'ënt Ngjallien, o Virgjërë,bëj të mirë shërbëtorët t'atë.

eti kje eti ...

Si gar i o Vasilevs tis irinis...

EVLOJITARIA ANASTASIMA

I Bekuar je o Zot , mësomë Ti tē dërejtat t'ote.

Lusma e ëngjëjvet°u famas tue par Tij⁺ o Shelbues çë tē vdekjies; fukjin sose e jose, °e çë bashkë me Tij Adhamin sgjove°e nga Pisa gjithënjeri lirrove. I bekuar...

374. + ndër tē vdekurit némruar,Tij,

ORTHROS I TË SHTUNIES

Përçë mirrat pérzieni me lotët° pér lipi-si , o dsënëse? °Engjëlli çë lambarisëj mbi varrin, °Mirëprurëset i thoshëj: shihëni ju °varrin e vërreni, °se Shelbuesi u ngre nga varri .

I bekuar ...

Menatnet njize °Mirëprurëset rrodhën° në varrin t'ënt°tue vajtuar; °po përparrë i dolli Engjëlli° e i tha:kjëroi i vajtimit sosi°, mos klani më; °po ngjallien e Krishtit° Apostojvet thonëji.

I bekuar ...

Grat mirëprurëse tuke ardhur me mirra te varri jit, o Shelbues,gjegjën zërin e Engjëllit çë thoshëj atireve : si ju ndër tē vdekuritë némëroni tē gjallin , se si Perëndì Ai nga varri u ngre.

dhoksa ...

I përmisemi Atit edhé Birit t'Tij edhé Shpirtit t'Shejt,Shejtes Trini në një klénie,tue thirrur bashkë me Serafimtë:i shejt,i shejt,i shejt,je,o Zot;

ORTHROS I TË SHTUNIES

kje nin Tue lindur Gjellëdhënësin shpëtove , o Virgjëreshë , Adhamin nga mëkata, e i dhe Evës gëzim në vend të helmit; atë çë ra nga gjella e ngrëfshit tek ajo pameta Aì çë ngah Ti u mishërua Perëndi edhe njeri. aliluja(3) lëvdì Tij , o Perëndi .

eti kje eti ...

Oti se enusi pase ...

EKSAP. I SHEJT IN ZOT PERËNDIA JINË

A I N O I

Çëdë frimë le t'lëvdonjë
t'ën'Zonë v.f;31.

Σῆμερον συνέχει τάφος... *Hxos* *β'*

Sët varri mban Atë çë te pëllëmba e dorës 'Tij mban gjithë kriesën.Guri pështron Atë çë me pushtet pështron kjielliat me pushtet. Gjella flë e Adhi dridhet e Adhami sglidhet nga lidhiet. Lëvdì kujdesit t'ënt paj t'çiqi-

ORTHROS I TË SHTUNIES

lit,kur gjithkjish u mbaruan,na dhe neve prëhie e pasosme,Ngjallien t'en-de e shejte së vdekurish.

Të tò òpawmëvov ... *Hxos* *β'*

Oh,pamie çë shihet:çë isht sot këjë prëhie? Rregji i jetëvet , pas çë mba-roi ekonomiën e pesimevet,prëhet te varri tue dhënë neve një e Shtunie e re. Atij na thërresiën: Ngreu o Perëndi sa t'gjikosh Dheun se.Ti rregjëron në jetë të jetëvet,Ti çë ke lipisin e madhe dhe e pamaturshme.

Δεῦτε Ὀψιεν ... *Hxos* *β'*

Ejani të shihëni gjellën t'ënë shtru-arë te varri sa të japën jë gjellë gjithë të varrzuamëvet. Ejani të shihëni stërnipin e Judhës çë flë e Atij me profetin thomii:ju shture e flë si luan; kush ka të t'ngrënëjë , o Rrekjë?

Pa ngreu me fukjin vetë t'ende Ti çë deshe të jipëje gjellën për ne .

O Zot , paçe lëvdì !

ORTHROS I TË SHTUNIES

'Htήσατο 'Ιωσήφ... *Hxos nij. p.*

Lipi Josifi Kurmin e Isuthit dhe e vuri te një varrë i ri i 'tiji se duhej sa të dilëj nga varri si nga nusëroria. O Ti çë drëmove pushtetin e morties e sbille diert e Parraisit njerëzëvet, paqe lëvdì !

dhoksa... Tèn σήμερον μυστικῶς... *Hxos nij. p.*

Moiseu simbolizoi mistikjisht ditën e sotme kur shkruajë E bekoi Perëndia të shtatëtën ditë: këjo isht e Shtunia e bekuame, këjo isht dita e prëhies, se nga gjithë vëprat e 'Tij i Biri i Vëtmiler i Perëndis u prë tue vdekur në kurm e tue u prierrë pameta te lëvdia nga e qila kishë jardhur, sa t'na jipëj neve gjellën e pasosme paj të t'ngjallurit e 'Tij si i vetëmi i mirë e njeridashës.

kje nin ... 'Υπερευλογημένη ...

ORTHROS I TË SHTUNIES

Ti je shum'e bekuame , o Virgjérë Mëma e t'in'Zoti:pr'anë t'Atij çë mori mishë ngah Ti Adhi kle lidhur, Adhami thërritur prapa,mahkimi kle shlier , Eva kle liruar,vrarë vdekjia e na pameta patëm gjellën. Prandai tue kënduar po thërresiën:I bekuar Zoti Krisht Perëndia jinë se kështu i pëlkleu. Lëvdì Tij !

Δ Ο Ε Ο Λ Ο Γ Ι Α

Lëvdì Tij çë dritën na dëftòn e çë jetën ndritëson.

Lëvdì në të lartitë Perëndis e mbi dhe pakjie,dhe ndër njerëzit vullnezë e mirë.

Himnojëm Tij,t'bekojëm Tij,t'permisi mi Tij, lavdërojëm Tij, të falnderojëm Tij për lëvdin t'ende të madhe.

ORTHROS I TË SHTUNIES

O Zot , o Mbret , i kjiellit Perëndi,Ati gjithëmëndshim,o Zot Bir i vettëmiler Iisu' Krishti dhe Shpirti i Shejt.

O Zot Perëndi,Kjenkji i Perëndis,i Atit Bir,çë ndsier mëkatën e jetës, lipisi për ne , o Ti çë ndsier mëkatët e jetës.

Prit mirë lutien t'ënë, Ti çë rri ujur tek e dërejta e Atit e kijna lipisi.

Se Ti vetëm je i shejt,Ti vetëm je zot,Iisu Krishti në lëvdì të Perëndis Atit,ashtu kloft.

Ditë për ditë do t'bekonj Tij,do të lavdëronj émbrin t'ënt për jetë e mbë jetë të jetës.

Bën-na të mirë,o Zot,të këjo ditë të ruhemë na të pamëkatë.

I bekuar je , o Zot , Perëndia i Atëravet t'anë,dhe émbri jit isht 380.

ORTHROS I TË SHTUNIES

i kënduar e i lavdëruar mbë jetë të jetëvet,ashtu kloft.

Kloft,o Zot,lipisia jote mbi ne,ashtu si kemi shpresuar tek Ti.

I bekuar je,o Zot;mësonë Ti të dërej tat t'ote.

O Zot,Ti pështrim ke klënë për ne brez pas brezi . U thash:o Zot,lipisi përmua:shëndoshëmë shpirtin se përparrë Teje mëkatrova.

O Zot,tek Ti u kam gjetur pështrim ; mësonë të bënjetë vullimin t'ënt,se Ti je Perëndia jim.

Se tek Ti isht burimi i gjellës; te drita jote do t'shohiën na dritë..

Sgjerò lipisin t'ënde mbi ata çë të njohiën.

O i shejti Perëndi,i Shejt i fukjishëm, i Shejt i pavdekshim,lipisi për ne.

Profetsia e Jezekjelit
(37,1-14)

Dora e t'in'Zoti jerdhi mbi nua e më mori e më kjelli në mes njëi fushie; e këjo fushë ish'e plotë me eshtra njerëzish.

2. E më kjelli sipër, rrethe, rrrotull atireve e ishën tepër shumë mbi faktjen e fushës e ishën të termë.

3. Pran më tha: Bir njeriu, mëndë këta eshtra të kenë gjellë përsëri? E u u përgjegja: o Zot, o Zot, këtë Ti e di.

4. E. Aì më tha: profetizò mbi këta eshtra e thuaji: eshtra të termë, gjegjëni fialën e t'in'Zoti.

5. Kështu' flet in'Zot këtireve eshtra: Shi! U bie juve frimën e gjellës, e do t'ju jap dejet, e bënj t'ju rritet mishët e do t'ndenj mbi ju likurën e do t'ju jap frimën t'ime e do

t'rroni e do t'dini se U jam in'Zot.

7. E u profetizova ashtu' si më urdhurroi in'Zot e si u veja tue profetizuar undje si një zë e gjithkjish zu të tundej e eshtrat të kjaseshën njerët t'jetravet e u bashkuan si i ngisëj.

8. E u vërrreja: e shi! mbi ata zun të dukeshën dejet, të rritej mishët e siper atireve jerdhi likura, po frimë gjellie ngë ishë edhë tek ata.

9. Edhë tha in'Zot: profetizò mbi frimën e thuaji frimës: këtë thot Zoti Perëndi: nga katrë erët eja e frij mbi këta të vdekurë e rrofshin.

10. E profetizova si më kle urdhuruar e hiri tek ata shpirti e zun të rrojën e u ngrëjtën mbi këmbët e 'tire:një mbëledhie tepër e madhe!

11. E më foli in'Zot tue thënë: bir njeriu, gjithë këta eshtra ishën populli i Israelit. Ata thonë: u tertën eshtrat t'anë, u sduk shpresa jonë, na u sbuartëm. Prandai profetizoi e thuaji:

ORTHROS I TË SHTUNIES

Këtë thot in'Zot: Shi' se U do t'sbill varret t'aj e do t'ju ndsier nga varret t'aj e ka t'ju kjell në dhe të Israelit. E ka t'dini se U, jam in'Zot si të sbill varret t'aj e t'ju ndsier nga varret t'aj, o populli jim. E ka t'ju jap frimën t'ime e ka t'jini gjallë, e ka t'ju vë te dhëu i jij e ka të dini se U in'Zot ju fola, thot Zoti Perëndi.

Prokjimenon: Ngreu, o Zoti Perëndia
jim; u lartësoft dora jo-
te; mos harrò të mjerët.

Dua ·të ·t'lavdëronj, o i
Madh'in'Zot, me gjithë
zëmërë; dua t'rrëfienj
famasmët t'ote.

Korinthianëvet e Para V, 6-8.Gal.3,
13-14.
Vëllezër, pak brumë të ngridhur bën
të ardhet gjithë brumitë. Pastronij
andai ngatë ngridhuritë të vietrë, sa
384.

ORTHROS I TË SHTUNIES

të jini brumë të ri pa të ngridhur, si edhé jini. Pse Krishti, Pashkët t'ote, u bë flijë pér ne. Prandai le t'kremtojën jo me brumitë të ngrishurë të vietrë, as me të ngridhuritë e të kekjies edhe të të ligës, po me brumë të patënggridhurë të thieshtis e të t'vertetës. Krishti na shpërbleu nga mahkimi i ligjës tue u bërt pér ne nalikim. Pse ë shkruar: "I mahkuam ai çë ë vierrë te druri".

Sa bekimi i Abramit mbi gjithë kombet të vij pr'anë të Iisu' Krishtit, sa të mirriëm të taksurën e Shpirtit me anën e besës .

U ngrëfshit Perëndia e klofshin shprishurë armikjët e 'Tij; e jikëshin nga fakja e 'tij ata çë i kanë mbëri.

Si kamnoi sduket, ashtu le t'sduken ata; si dillët joset përpara ziarrit, ashtu kan't' humbiën të mëkatruamitë përpara Perëndis; e të drjtitë ka t'gëzonen.

V a n g j e j i

(Mt.27,62-66)

Mbë ditën e nesërme, ç'isht ajo pas të Prëmpties, u mbëjodhën kriepriftrat edhë Farisenjtë te Pilati e i thonë: Zot, u kujtuam se ai gënjeshtar tha, kur ishë gjallëmbi tri ditë ka t'ngrëhem. Ti urdhurò sa të jet ruajtur vərrı njera tek e treta ditë, mos t'vijën dsënësit e 'tij natën e t'e viedhiën e të thenë popullit: "u ngjall së vdëkurish": e të jet e sprasmia gënje-shtrë më e kekje se e para. E Pilati i tha atire: ju kini ushtarë pér të ruajtur: etsëni, ruanie si dini. E ata van'e vulosën gurin e i vun shtrazët te vərrı sa t'e ruajën.

Ipomen pandes... Plirosomen...

APOLISIS: Zoti Krisht çë pér ne njerëzë e pér shëndetën t'ënë deshi të vuajtë dreruashmë pesime e Krikjien gjellëbërëse e Varrin, i vërteti Perëndia jinë paj të Shë Mëris e dëlira Mëma e 'Tij e paj të gjithë shejtravet na shpëtoft e me lipisi na ruashit si i Mirë

e njeridashës.

*Ndërsa thuhet i pari msalm (f.155)
Prifti thot mistikisht këto lutie:*

O i Madh'in'Zot i dhëmbëshëm e lipisiar, i duruashëm e shumë mëshiri, prirveshin t'ënt parkalesis t'ënë e vër re zërit e luties t'ënë.

Bëj me ne një shenk pér të mirë; udhë-hékjëna te dhromi i jit sa na të jetsi-ëm tek e vërteta. Mbush me gjëzim zëmburat t'ona sa na t'i trëmbemi émbrit t'ënt. Pse Ti je i mathë e çë bën famasmë! Ti i vetëmi Perëndi! Mosnjeri nga perëndirat të glet Tij, o i Madh'inë Zot, i fort te lipisia e i mirë te fukjia, te të ndihurit, te të ngushëlluarit, te të shpëtuarit gjithë ata çë shpresojën te émbri jit i shejt.

Se Tij të ngjet çëdë lëvdì, ndër e të përmisur ...

ESPERINOI I TË SHTUNIES

2. O i Madh'in'Zot, mos më kjërtò te mbëria jote, mos më mundë te zëmërimi jit, po të bësh me ne si Ti ndëlgon më mirë, o Mieku e Shëndonjësi i shpirtravet t'anë. Udhëhékjëna te limani i vullimit t'ënt; ndrit sit e zëmbravet t'ona sa të njohiën të vërtetën t'ën-de efalna çë kjëndron të kësaj ditie e gjithë motin e gjellës t'ënë në pakje e pa mëkatë, paj të Mëmës e t'inë Zoti e të gjithë Shejtravet.

3. O i Madh'in'Zot, i vetëmi Perëndia i jinë, kujtou për ne shërbëtorët t'atë të mëkatruamë e të padobishmë e mos na le të ndiejëm turp te të priturit lipisin t'ënde ..

Po dhurona, o i madh'in'Zot, gjithë ndihmat çë po na duhen për shpëtimin t'ënë e bën-na të zotë të Të duam mirë, të Të trëmbemi me gjithë zëmërë

ESPERINOI I TË SHTUNIES

e të bëjëm te gjithkjish vullimin t'ënt.

4. O Ti çë je lëvduar me himne çë vazhdojën pa pushim, nga shejtet Pushtetie, mbush gojën t'ënë me lëvdimin t'ënt sa na të madhërojëm embrin t'ënt të shejt e ëna piesë e trazhgim me gjithë ata çë vërteta të trëmben e ruajën urdhurimet t'atë.

5. O i Madh'in'Zot , i Madh'in'Zot , çë gjithkjish mban mbi pëllëmbën e dorës t'ënde ,çë ke lipisi për gjithë ne, çë dhëmbe për gjithë kekjas t'ona, kujtò mëshirët t'atë, lipisin t'ënde.

Eja shihëna te mirësia jote e ëna , për sa kjëndron të kësaj ditie, të mba-jëm largu ngatërrimet gjithë llojësh të të ligut e me hirin e gjithëshejtit Shpirt t'ënt ruaj gjellën t'ënë re lirë nga çëdë prite. Me lipisin e dashamirësin e të vetmit ler Bir t'ënt me të cilin Ti je i bekuam bashkë ... 389.

ESPERINOI I TË SHTUNIES

6. O Perëndì i mathë dhe i famasë-sëshëm çë me një të parrëfleshme mirësi e një parakujdes të mathë kjëvarris gjithkishë; Ti çë na dhe neve të mirat e jetës e çë me këto të mira dha të falura neve sikurse na jep një penk të të taksurës rregjëri; Ti çë për piesën e shkuame të ditës na bëre të mbajëm largu çëdë e ligë, bëj sa edhë piesa çë na vjetet të ditës të shkonjë e pakjërtuashme përpëra lëvdis s'ate e shejte tue lëvduar. Tij, i vetëmi Perëndì jinë i mirë e njeridashës. Se Ti je Perëndia jinë e na të japiëm lëvdì Tij ...

7. O Perëndì i mathë e i lart, i vëtëmi i pavdekshim, dritë e pakjasurshme, çë bëre gjithë kriesën me dituri, çë ndajte dritën nga errësira e vure

390.

ESPERINOI I TË SHTUNIES

diellin të zotëronjë ditën e hënëzën e ijëzit sa të zotërojnë natën; Ti çë na bëre të mirë, megjithëse të mëkatruamë, të arrëjëm te këjo herë të para-kjitemi përpëra fakjies s'ate sa të Të këndojojmë e të faliëm lëvdin e mbrëmies, Ti, o i Zoti dashamirës, ndrekjë parkalesin t'ime si livan përpëra Teje e prite për të mirën erë të përshpir-tshme; falna këtë mbrëmë e natën çë vien me pakjie; ngjeshna me armët e dritës; ruajna nga dreja e natës e nga çëdë veprim çë punonet te të më t'errëtitë e ëna gjumin çë Ti na fale për prëhie ligështis t'enë, të lirë nga çëdë fantasi e diallit. Ëj, o i Zoti i gjithësis, dhënësi i të miravet, ëna sa na, të klënitet mbi shtretrat t'anë, biérshim në mendë mëkatët t'ona e i klafshim si të kujtofshim embrin t'ënt e, kur t'u kemi sgjuar, të ndriturë nga mejtimi i urdhurimevet t'atë, u ngrëfshim me gëzim shpirti sa të vijëm të lëvdojëm mirësin t'ënde tue falur mëshirit t'ënt lutie e parkalesi për mëkatët

391.

t'ona e të gjithë popullit t'it të çi-lin, paj të Mëmës s'Perëndis eja e shih te lipisia jote. Se Ti je i mirë e një-ridashës e na të japiën lëvdì Tij Atit, Birit e Shpirtit Shejt përherë, nani e gjithëmonë e për jetë të jetëvet, amin.

*për msalmet Kjirie ekjekraksa etj...
kërké f.161 etj.*

Taqë éspëriu nac hënëvës e uchës ...

Prit mirë lusit t'ona të mbrëmëshme, o Zot i shejt, e ëna neve ndëjésën e mëkatëvet, se Ti je i vetëmi çë dëftove në jetë Ngjallien.

Kuqlósatës laoës Sëwv...

O popuj, etsëni rrrotull Sionit e rrethone e jipëni lëvdì tek të Ngjallurit së vdekurish. Se Aì isht Perëndia jinë, Aì çë na liroi nga paligjësit t'ona.

Δεῦτε λaoës ...

Ejani, o popuj, le t'himnojëm e proskjini siem Krishtin tue lëvduar Ngjallien e 'Tij së vdekurish. Se Aì isht Perëndia jinë, Aì çë na liroi nga gënjeshtra e armikut.

Tëp Páthesi sou ...

Me pesimet t'atë, o Krisht, na klemë liruar nga epshet t'ona e për Ngjallien t'ende klem shpërbllér nga prishëria. O O i Madh'in'Zot, paqe lëvdì !

Sýmeporov ò "Aðngs stégnawn Boq...

Adhi tue vajtuar ulurin:më mirë mos kisha pritur të Lerin e Maries. Pse, si jerdhi tek u, jos i pushtetin t'im, drëmoi diert hekuri, shpirtrat çë më para mbaja, posa Aì isht Perëndi, i ngjalli. Lëvdì, o Zot, Krikjies t'ende, Ngjallies t'ende !

Sot Adhi ulurin tue vajtuar:Pushteti jim kle prishur;këllita brënda një i vdekur si gjithë t'jerët,po ngë mënd't'e mbanj krejt e ka t'sbier gjithë t'jerët mbi të çilët urdhuroja çë moti. Çë moti kisha u të vdekurë, po Ti m'i ngjalle gjithë. Lövdì,o Zot,Krikjies t'ënde,Ngjallies t'ënde!

Sot Adhi ulurin tue vajtuar:kle gjëllitur pushteti jim. Delmeri kle vënë ngrikjë e ngjalli Adhamin. Më ndsori gjithë ata mbi të çilët rregjëroja . Volla gjithë ata çë kisha gjëllitur. Lövdì,o Zot,Krikjies t'ënde,Ngjallies t'ënde.

d h o k s a ... (f.378) Τὴν σύμερον
kje nin ... Τὴν παγιόσμιον δόξαν ...
Me lövdì,si duhet,le t'himnojëm Vir-gjörën Mëri çë,e lindurë nga njerëzit, na lindi t'ën'Zonë. Oh,dera e kjielliës, kendimi i Ëngjëjvet,stoli e njerëzëvet!

Ajo u dëftua pë'ftet si një kjiell e throni i Hjynis. Ajo shturi posht murin e mbëris e tue sbillur shpin e Rregjit, na dha pakjien. Tue pasur këtë angjirë e besës kemi Kë na mbron,të Birin e'Saj e Zotin t'ënë.

F O S I L A R O N
(f.167)

P r o f e e t s i t

1. Piesë nga TË BËRIT (I,1-13)

Të zënit 'n fill Perëndia bëri kjieliën e dheun. E dheu ishë i pa-të dukur e i pa-gjë fare e të errëtitë ishë mbi fakjien e honit, e shpirti i Perëndis sillej mbi ujërat. E Perëndia tha: u bëft drita e drita u bë. E Perëndia pa se drita ishë e mirë e ndajti dritën nga të errëtitë. E dritën e thriti ditë

e të errëtitë n a t ë . E mbrëmie e menatë u bë dita e parë. E Perëndia tha: u bëft një të ndejtur në mes të ujéravet,e kloft këta në mes çë ndan ujë nga ujë. E kështu u bë. E Perëndia bëri të ndejturit e ndajti në mes ujërat çë janë sipër të ndejturit. E Perëndia këta të ndejtur e thriti k jte l l .

E pa Perëndia se ishë mirë. E mbrëmie e menatë u bë dita e dijtë.

E Perëndia tha:le të mbëjidhen ujërat çë janë përposh kjielliës mbë një vend bashkë e le t'duket të termit. E u bë kështu'. E ujërat çë ishën përposh kjielliës,u mbëjodhën bashkë te vendet e 'tire e u duk të termit. E Perënia të termit e thriti d h e , e të mbëjetdhurit e ujéravet e thriti d e j t.

E pa Perëndia se ishë mirë. E Perëndia tha:le t'shtienjë dheu bar të njojmë,bar çë bën farë,e dru pemie çë bën

pemë:llojet nga-një t'i glasënëjë farës e 'tijë,e të jet tek ai fara e 'tij te llojeja e 'tij mbi dhet. E u bë kështu'.

E dheu shtu e dha bar të njomë,bar çë bën farë mbë llojet gjah fara e 'tij,e dru ne pemë ashtu si fara e 'tij ndë 'të mbë llojet e 'tire mbi dhet. E pa Perëndia se ishë mirë. E mbrëmie e menatë u bë e treta ditë.

2. Piesë nga libri i Isaïs Profet.

(LX,1-16) Ndritu ,ti,o Jerosolimë,pse të jerdhi drita jote e lëvdia e t'inë Zoti mbi tij u dëftua. Shi' se të errëtitë ka të pështronjë dheun e do t'jet mjegullë mbi gjinden: e mbi tij ka të lehet in'Zot e lëvdia e 'Tij ka të duket. E rregjérat ka t'jetsiën me dri-tën t'ënde e gjindet me të shkëlkjërit t'at. Ngre sit t'atë rrëth e rrotull e shih të mbëjedhurë tu bij e tu

bija ka t'jen kjellur mbi krahët. Atë herë do t'shohësh e do t'gëzonesh: do t'shkundesh e të sgjeronet zëmbra, kur tek ti do t'priret buria e dejtit e të gjindes e të popujvet. Lusma kanilesh kanë të vijën tek ti e kanë të të mblojën kamilet e Madhianit edhë të Jefës.

Të gjithë nga Saba do t'vijën tue prur ar e klem(livan) e gurë të çmuamë e do t'ligjerojën të shpëtuarit e t'inë Zoti. E delet e kjindarit të gjitha kanë të mbëjidhen tek ti: e ka t'vinjën tsiept e Nabeethlit e të pritur ka të jen falur mbi theroren t'ime: e shpia e lusis t'ime ka t'jet lëvduar.

Kush janë këta çë shpejt venë si mje-kulla e fluturojën si pallumbesha me zokjët e 'tire mbi mua? Mua më presiën ujdhesat e lundrat e Tarsit çë më përpara, sa të bie tij tu bij nga vende 'n

sö largu e bashkë me ata, 'rrggjëndin e arin e 'tire; paj t'ëmbrit shejt e të in'Zoti, e paj t'jet i lëvduashëm Shejt i Israëlit.

E të huajit kanë të ndërtojën muret t'atë e rrëgjërat e 'tire do t'stenem tij sa të t'shërbëjën: se te mbëria jime u të ksita e te lipisia u të desha mirë.

Diert t'ote kanë të jen të sbëllime gjithë herët; ditë e natë ngë kanë të mbillen, sa të këllitet tek ti fukjia e gjindevet edhe rrëgjërat e 'tire çë tij të bien. Përse gjindet edhe rrëgjërat çë ngë do t'shërbëjën Tij, kanë të sbinren e ato gjinde si të shkretë ka t'jen shkretuar e përfaruar.

E lëvdia e Libanit ka t'vinjë tek ti me kji parise, me pefkje e me kjedre sa të lëvdonjë vendin e kömbëvet t'ime.

E kanë të vijën tek ti të trëmburë të bijët e atire çë tij të shtun posht e të shkarzien. Kanë të përmisen te gjurmët e kömbëvet t'ote gjithë ata çë të shkarzien. Se ti ishe lënë e vetme, e harruamë e ndë mbëri të gjithëve e ngë

ishë njeri çë vij e të ndihëj. E u dua tjesh lëvdia te gjithë motet, gëzimi te gjithë jinit. E ti ke të thithësh klëmësht gjindesh, e ke të hash kjosmë rre gjérash; e ke të dish, se U jam i Zoti çë të ruanj, jam U çë të lironj, Perëndia i Israelit.

3. Piesë nga të DALIT (XII,1-11)

In'Zot i foli Moiseut e Aaronit në dhe t'Egjiptit tue thënë: ki muaj për ju isht kreu i muajëvet: për ju isht i pari ndër muajit e vitit. Ti flit te gjithë mblëdhia e të bijëvet e Israelit e thuaji atireve: tek e dhietëta ditë e këtij moi nga-një le t'marrënjë një kjenkjë për nga shpi të fëmijës'tij:nga-një një kjenkjë për shpi.

Në pra u ndothëshin pakë vetë te shpia, akjë se ngë arrëjën t'e han kjenkjin, ai le t'marrënë një më 'të gjitonin çë ka më afër shpis e 'tij, përsa isht numëri i shpirtravet:nga-një të

jet nömëruar përsa i duhen të han kjenkjin. E kjenkji ka t'jet i tërë, pa dserkje, mashkull e njëi viti:ka t'e mirroni nga kjenkjet e nga katsikjtë. E ju ka t'e ruani njera tek e katrëmbëdhietëta ditë e këtij muaji: e gjithë shumiza e mbledhies e të bijëvet e Israelit nga njeri ka t'e therënjë mbë të ngrisurit e ditës. E ka t'marriën nga gjaku i kjenkjit e ka t'liejën di furkjet(anët) e derës e prakun e sipërm të derës të shpivet, ku ata ka t'e han. E tek ajo natë ka të han mishët e kjenkjit të pjekur te ziarri, ka t'han bukë të gjesurë pa brum të ngridhur me barin e pikridhes. Ka kjenkji ngë ka të hani gjë të papjekur te ziarri, jo të zier te ujët, po të piekur te ziarri:ka t'i hani kriet, këmbët dhe brëndeshat(zorrët).

Ngë ka t'i lëni gjë, njera menatnet: e ngë ka t'i çani një asht. Në edhé vjetet gjagjë:njera menatnet ka t'e digjëni te ziarri. E ka t'e hani kësh:tu':mesin shtrënguar ne rrëthim, këputët te këmbët, shkopin te duart e do

ESPERINOI I TË SHTUNIES

t'hani shpejt shpajt: se këto janë Pashkët, të shkuarit e t'in'Zoti.

4. Piesë nga libri i Jonës Profet (III,1-10;IV,1-11)

Jonës të birit e Amathit in'Zot i foli e i tha: ngreu e jets te kjitet i mathë ndë Ninivë:atié ligjérò e kjér-tò, se thirma e të kekjëvet e 'tire arrû njeraq tek U. E Jona u ngre të jikëj nga fakjia e t'in'Zoti: e vate për Jopën, e gjeti një lundrë çë vej në Tarsë 'n s'largu nga Fakjia e t'in'Zoti.

E in'Zot smoli një erë e fortë mbi dejtin e u ngren suvala të mëdha te dejti e lundra ishë dre të plasëj.

E dejtarët ishën të dreruamë e nganjë thërrisëj Perëndin e 'tij: e muarnë të shtijën te dejti lagjet e çëdë barrë kishën te lundra, sa t'e lehtësojën. Po Jona posht te fundi i lundrës u shtu të fløj errëfëllisëj. E ju kjas kaptenja e i tha: E çë,ti rrëfëllis? Ngreu e thrit Perëndin t'ënt, në do t'na shpëtonjë Pe-

ESPERINOI I TË SHTUNIES

rëndia e mos të sbiremi.

Pran thanë njeri t'jatrit nd'anë:ejë ni e shtiem shortët sa të dime ngaha na vien këjo e kekje. E shtun shortët e shorta i ra mbi Jonë. E ata i thanë atij: Pa dëftona ti, përqë na kle neve këjo e zezë? Çë punë ke ti? e nga çila horë e çë farë gjindesh je ti? E aì i tha atireve. U jam Ebré, shërbëtar i t'in'Zoti: e i falem Zotit Perëndi të kjielliës; i qili bëri dejtin e dheun.

E u trëmbën ata burra me një dre të madhe e i thanë atij: përqë ti bëre këtë shërbes? pse ata burra ndëlguan se aì kishë jikur nga fakjëja e t'in'Zoti, se ai ja kishë rrëfiejtur. E ata i thanë atij: Çë kemi të bëjëm tij, sa të sbutsonet dejti me ne? pse dejti më çë vej, më shumë ngrëj suvalat. E Jona i tha atireve: më mirräni e më shtini te dejti, e ngak ju do t'largonet dejti. Përqë u e di, se për mua janë mbi

ju këto suvala të mëdha. E ata burra bëjën fukjì, sa të prireshën te dheu, e ngë mëndë ja bëjën se dejti më çë vej, më shumë ndrashej mbi ata. E zun të lurijën tek in'Zot r thoshiën Zot, mos klofshit! mos të sbiremi pér gjellën e këtij njeriu, e mos na sht: ngrahë mbi ne gjak të drejt, pse, Ti o Zot, ke bër ashtu si dejti. E muartin Jonën e e shtun te dejti, e dejti u mba nga vala e 'tij, sosi të tërbuari.

E ata burra me një dre të madhe ju trëmbën t'in'Zoti e i falën t'in'Zoti flijë e julutën me urata e me të taksura. E in'Zot i kishë urdhuruar njëi pishku të mathë, sa të gjëllij Jónën: e mbeti Jona te barku i pishkut tri ditë e tri netë. E Jona nga barku i pishkut zu t'i lutej Zotit Perëndi e thëshëj: Te helmi jim u i

thirra t'in'Zoti Perëndis t'im, e Aì m'u përgjekj: thirma jime nga baku i varrit e ti më gjegje zërin t'im. Ti më shture humbët në mest të dejtit: e lume uji më rrëthuan: të gjithë valët t'ote e suvalat shkuan mbi mua e më pështruan.

E u: thash: jam i përzënë në vent 'n së largu sivet t'atë: mbi gjithë u do t'thom se kam të shoh pameta Faltoren e Shejtëris t'ënde. Ujët më ka pështiellë njera te shpirti : honi më i humbët më ka rrëthuar: krijet t'imë humbi posht brënda dheut, ku prangët e 'tij e mba-jën gjithëmohë. E nga humbia letë ngrëhet tek Ti gjelle jime, o Zoti Perëndia jimë. Kur ish'e më shkulej shpirti i jim, u kujtova ka in'Zot: e jarshit tek Ti lusia jime te Faltorëja e shejtëris t'ënde. Ata çë ruajën të kota e të rrëme, ata lërëjën pér 'ta lipisin.

ESPERINOI I TË SHTUNIES

Por u me zë lëvdije e lëvdërie, dua të t'fal Tij flijë:sado të taksa ndë uratë,kam të t'e jap pér shpëtimin t'in:seshpëtimi isht i t'in'Zoti.

E in'Zot i dha urdhurimin pishkut e pishku e ndsori jashta gojës Jonën e e la në dhe i term. E in'Zot i bë filalë Jonës të dijtën herë e i tha:

Ngreu e jets te kjiteti i mathë ndë Ninivë e atié thirr e ligjérò ashtu si më para të bëra fialë. E Jona ungre e vate Ninivë;ashtu di i foli in'Zot. Niniva ishë një kjitet shumë i mathë,si tri ditë të jetsur. E Jona hiri brënda horës e zu të jitsëj si një ditë dhrom: e thërrisëj e thoshëj: edhé dizet ditë e Niniva ka t'jet gorromistë. E ata të Ninivës patën besë te Perëndia: e urdhuruan argjërim e u veshën me these të gjithë çë nga më i madhi i 'tire njera te më i vogëli i 'tire. E fiala arru rregjit e Nini-vës: e aì u nGRE nga throni i 'tij e 406.

ESPERINOI I TË SHTUNIES

shtu mbë nj'anë pethkat e 'tija e u veshë me një thes e u uj mbë hi. E kleshtur thirma e u tha ndë Ninivë pér urdhur të fregjit e të të Mëdhenjë vet, tue thënë:Burrat edhé kafshat,kjet edhé delet mos të ngjepsiën gjë,mos të kulotiën,mos të pin edhé ujë. E ata u pështruan me these, burra e kafsha e thritën fort e glat Perëndiç e nga-një u pruar nga dhromi i 'tirei kekjë e nga paligjëria e 'tire , çë kishën pér duarshit e 'tire. Ata thoshiën: kush e di në Perëndia do të ndërronjë mendë e do t'jet parkalest të na ndëjénjë e do të köthehet nga tërbimi i mbëris s'tij, e na të mos sbiremi ?

E Perëndia pa veprat e 'tire , se u pruarën nga udhët e 'tire të kekje: e ndërrroi mend Perëndia e pati lipisi e la mos t'i bëj atire të ligën çë kishë thënë, e ngë ja bëri. E u helmua Jona me një helm të mathë e u trazua e zu t'i lutej t'in'Zoti e thëshëj:

ESPERINOI I TË SHTUNIES

Por u ne zë lëvdije e lëvdérie, dua të t'fal Tij flijë:sado të taksa ndë uratë,kam të t'e jap pér shpëtimin t'im:seshpëtini isht i t'in'Zoti.

E in'Zot i dha urdhurimin pishkut e pishku e ndsori jashta gojës Jonën e e la në dhe i term. E in'Zot i bë filalë Jonës të dijtën herë e i tha: Ngreu e jets te kjiteti i mathë ndë Ninivë e atié thirr e ligjérò ashtu si më para të bëra fialë. E Jona u ngre e vate Ninivë;ashtu di i foli in'Zot. Niniva ishë një kjitet shumë i mathë,si tri ditë të jetsur. E Jona hiri brënda horës e zu të jitsëj si një ditë dhrom: e thërrisëj e thoshëj: edhé dizet ditë e Niniva ka t'jet gorromiastë. E ata të Ninivës patën besë te Perëndia: e urdhuruan argjërim e u veshën me these të gjithë çë nga më i madhi i 'tire njera te më i vogëli i 'tire. E fiala arru rregjit e Nini-vës: e ai u ngre nga throni i 'tij e 406.

ESPERINOI I TË SHTUNIES

shtu mbë nj'anë pethkat e 'tija e u veshë me një thes e u uj mbë hi. E kle shtur thirma e u tha ndë Ninivë pér urdhur të tregjit e të të Mëdhenjë vet, tue thënë:Burrat edhé kafshat,kjet edhé delet mos të ngjepsiën gjë,mos të kulotiën,mos të pin edhé ujë. E ata u pështruan me these,burra e kafsha e thritën fort e gëlat Perëndia e nga-një u pruar nga dhromi i 'tirei kekjë e nga paligjëria e 'tire , çë kishën pér duarshit e 'tire. Ata thoshiën: kush e di në Perëndia do të ndërronjë mendë e do t'jet parkalest të na ndë-jénjë e do të këthehet nga tërbimi i mbëris s'tij, e na të mos sbiremi ?

E Perëndia pa veprat e 'tire , se u pruarën nga udhët e 'tire të kekje: e ndërrorri mend Perëndia e pati lipisi e la mos t'i bëj atire të ligën çë kishë thënë, e ngë ja bëri. E u helmuva Jona me një helm të mathë e u trazua e zu t'i lutej t'in'Zoti e thëshëj:

ESPERINOI I TË SHTUNIES

O Zot, ngë ishën käto të folat t'ime,
kur edhé ndodhesha te dheu i jim?

Prandai u shpejt mora të jikia në
Tars, pse u e dija se Ti je i but, i li-
pisës, i zëmbërëgjerë, se të duket ke-
shumë e se ndëjén të kékjat. E nani, o
Zot e i Zot, mirmë shpirtin se isht më
mirë pér mua të vdes, se të rronjë.

E in'Zot i tha Jonës; isht mirë se ti
t'u kesh mbrijtur kështu'? E Jona do-
lli jashta kjitetit e vate e u vu n'
ball të kjitetit : e atié bëri pér 'të
një kalive e mbeti pérposh asaj në hjé
njera kur të shihëj çë ki't'i streksëj
kjitetit. E Zoti Perëndia urdhuroi
njëi urdhi e u rrit e u ngre mbi kriet
e Jonës sa t'i bëj hjé atié sipér mbi
kriet e 'tij, së t'e prëj nga helmet
e 'tij: e Jona me urdhin pati gjëzim
të mathë. E Përëndia mbë nesër dërgoi
një krimp si ish'e dihej atë menatë e
krimbi rrahu e shpëti urdhin i çili u
sverth e u tha. E të dalit dielli,
streksi se Perëndia urdhuroi njëi erie

ESPERINOI I TË SHTUNIES

të ngrohtë çë digjëj:dielli i ra mbi
kriet e Jonës, e ai u zalës, e dishiroj
të vdisëj e tha:më mirë pér mua të vdes
se të rronjë. E Perëndia i tha Jonës :
të duket mirë se të mbrihesh pér urdhin?
E ai tha: po:se fort u kam helmuar u
njera të vdisia. E in'Zot i tha: ti de-
she të kurseje urdhin, të duket kekjë
pér atë urdhin pér kë ti ngë reve gjë,
ngë e bëre ti të rritej:ai te një natë
leu e te një natë vate. E U ngë ka të
kursenjë Ninivën, t'e ndëjénjë një kji-
tet të mathë, tekujesiën më shumë se
një kjint e një zetë mijëra njerëzish,
të cilët ngë din të njohien të drejtën
dotë e 'tire e të shtrëmbërën e 'tire,
me disa kafsha ?

Piesë nga libri i Josueut V,10-16.

Të bijët e Israelit u mbajtën atié nën
tendëvet ndë Galgalë e bën Pashkët mbë
të ngrisurit e ditës katrëmbëdhietëtë
të t'parit muaj, te fuashat e Jerihoit
mb'at'anë të Jordhanit, nga hump dielli.